

PROTOKOLL PUNE

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL NË KUADËR TË REHABILITIMIT DHE RIINTEGRIMIT TË TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

DRAFT

Tiranë, Mars 2024

Lista e shkurtimeve

ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
DNJ	Drejtoria e Ndhmës Juridike
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur
IEVP	Institucionet e Ekzekutimit të Vendimit Penal
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës
MD	Ministria e Drejtësisë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
QPKMR	Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve
SMD	Strategjia e Drejtësisë për të Mitur

DRAFT

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	4
1. QËLLIMI I PROTOKOLLIT DHE PËRDORUESIT	6
1.1. QËLLIMI.....	6
1.2. PËRDORUESIT	7
2. KUPTIMI I KONCEPTIT TË RIINTEGRIMIT TË TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN	12
2.1. KUPTIMI I RIINTEGRIMIT	13
2.2. STANDARDET MINIMALE NDËRKOMBËTARE TË RIINTEGRIMIT TË TË MITURVE NË KONFLIKT ME LIGJIN	14
2.3. PARIMET NGA TË CILAT UDHËHIQET PROCESI I RIINTEGRIMIT	16
3. REHABILITIMI DHE RIINTEGRIMI I TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL	17
3.1. VEPRIMTARIA PARANDALUESE	18
3.2. RIINTEGRIMI I TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN NË FAZA TË NDRYSHME TË PROCEDIMIT PENAL	20
3.2.1. Vlerësimi individual i të miturit në fazë të ndryshme të procedimit penal	21
3.2.2. Zbatimi i masës alternative të shmangies.....	28
3.2.3. Gjykimi i çështjes/vendimi penal ndaj të miturit.....	45
4. PROCESI I RIINTEGRIMIT TË TË MITURIT PAS VUAJTJES SË DËNIMIT ME BURGIM/LIRIMIT ME KUSHT	55

HYRJE

Të miturit mund ta gjejnë, shpesh, veten si viktimë apo dëshmitarë të veprave penale, po ashtu edhe si autorë të tyre. Këta të mitur, të cilët përballen me sistemin e drejtësisë, është e rëndësishme që të gëzojnë garancitë procedurale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, pasi mënyra e trajtimit, procedimit penal, dënimit dhe rehabilitimit/riintegritimit të tyre reflekton sistemin e vlerave të një shteti. Nisur nga veçoritë e procesit penal me të mitur, qëllimi kryesor i sistemit të drejtësisë për të mitur duhet të orientohet nga nevojat për rehabilitim dhe riintegrim shoqëror të tyre dhe institucionet shtetërore duhet ta mbështesin vendimmarrjen tek interesi më i lartë i fëmijës.

Shqipëria ka një popullsi prej 2.761.785 banorë. Rreth 329.937 prej tyre janë të grup-moshës 10 deri në 19 vjeç (12%)¹. Të dhënat e Raportit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi kriminalitetin në Shqipëri për vitin 2022², tregojnë se janë regjistruar 821 procedime penale ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin (në vijim të mitur) duke shënuar një rritje prej 16.6% krahasuar me 2021. Janë regjistruar 572 të mitur si të pandehur ose persona nën hetim për kryerjen e një veprave penale dhe për 25 prej tyre është vendosur masa e sigurimit personal arrest në burg. Lidhur me zbatimin e masave alternative të shmangies, nga të dhënat rezulton se në shumicën e çështjeve me të mitur është zbatuar shmangia dhe që zbatimi i masave të shmangies ka ardhur në rritje vit pas viti. Gjatë vitit 2022, janë regjistruar 833 çështje në ndjekje me 873 viktimë të mitur. Sipas statistikave zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, gjatë periudhës 2015–2021 janë dënuar 2392 të mitur, kryesisht për krime (73%). Numri i të miturve të dënuar ka prirje drejt uljes në raport me vitin 2015. Gjatë periudhës 2017–2021, gjykatat kanë zbatuar alternativa të dënimit me burgim për 1084 të mitur³. Në raport progresin e Komisionit Evropian për Shqipërinë 2023, vlerësohet se kuadri ligjor dhe politik për të drejtat e fëmijës reflekton gjithnjë e më shumë standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e BE-së. Megjithatë, mekanizmat e koordinimit duhet të përmirësohen ndjeshëm për të siguruar zbatimin e plotë të kuadrit ligjor⁴.

Shqipëria ka bërë punë të konsiderueshme me ratifikimin instrumenteve ndërkombëtare dhe përmirësimin e legjislacionit të brendshëm për të drejtat e fëmijëve dhe administrimin e drejtësisë për të mitur, por mbetet ende punë për të bërë për zbatimin efektiv të këtij legjislacioni. Në kuadër të reformës në drejtësi është miratuar ligji nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” (në vijim KDPM) dhe ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve për trajtimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Më datën 1 Janar 2018 hyri në fuqi Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili vlerësohet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe *acquis*⁵ dhe përmban norma të posaçme ligjore lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin

¹ Popullsia e Shqipërisë, 1 Janar 2023, botuar nga INSTAT më <file:///C:/Users/User/Downloads/popullsia-e-shqiperise-1-janar-2023.pdf>

² Raporti i Prokurorit të përgjithshëm mbi kriminalitetin në Shqipëri për vitin 2022, fq. 19,

[file:///C:/Users/User/Downloads/Raporti_Vjetor_kriminaliteti_2022_Kuvendit_Prokuroria_e_Pergjithshme_6915%20\(5\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/Raporti_Vjetor_kriminaliteti_2022_Kuvendit_Prokuroria_e_Pergjithshme_6915%20(5).pdf)

³ Vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë, 2021, <https://www.drejtesia.gov.al/statistika/>

⁴ Raport Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2022, fq.6, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

⁵ Relacioni shoqëruar i projektligjit “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, fq.22; <http://www.drejtesia.gov.al/strategjia-e-drejtise-per-te-mitur/>

gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, riintegrimin e rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale, si dhe rregulla për të rinjtë nga grup-mosha 18 deri në 21 vjeç. Ligji garanton një kornizë ligjore për drejtësinë penale për fëmijët, promovon riintegrimin e fëmijës në konflikt me ligjin, mbrojtjen e të drejtave të fëmijës viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale dhe parandalon riviktimizimin e fëmijës që ka qenë më parë viktimë e një vepre penale ose viktimizimin dytësor të shkaktuar si pasojë e pjesëmarrjes në proceset e drejtësisë. Kodi është një ligj i veçantë për shkak të përmbajtjes së tij pasi përmbledh të gjitha dispozitat që referojnë të miturin në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe ligje të tjera referuese të sistemit të drejtësisë penale për të mitur.

Qasja shumë disiplinore në drejtësinë miqësore për të miturit, është një tjetër risi që sjell KDPM, duke bërë që sistemi i drejtësisë për të mitur të shikohet në mënyrë integrale dhe shumë disiplinore. Një sërë institucionesh dhe profesionistësh, mund dhe duhet të bashkëpunojnë jo vetëm në parandalimin, por edhe në përcaktimin e masave restauruese më të përshtatshme për fëmijët në konflikt me ligjin, sidomos për rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre. Bashkëpunimi i ngushtë midis profesionistëve të ndryshëm siguron një vlerësim të fëmijës në disa aspekte si juridik, psikologjik, social, emocional e fizik për të siguruar mbështetjen e nevojshme për një vendimmarrje në interesin më të lartë të fëmijës.

Pavarësisht parashikimeve të KDPM, mund të themi se për sa i përket respektimit në praktikë të të drejtave të të miturve në konflikt/kontakt me ligjin dhe përmbushjes së detyrimeve të institucioneve përgjegjëse mbetet ende shumë për tu bërë. Ka ende shumë nevojë për njohjen dhe respektimin e standardeve për një drejtësi miqësore për fëmijët dhe për mbështetje me burime njerëzore dhe financiare të shërbimeve në drejtësinë për të mitur. Kuadri ligjor ka nevojë të përmirësohet për të adresuar një mbrojtje më të mirë të fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin. Masat alternative të shmangies nuk kanë zbatim të njëjtë, disa prej tyre janë zbatuar në pak raste ndërkohë që masa më e zbatuar është paralajmërimi me shkrim. Numri i fëmijëve në konflikt me ligjin të përfshirë në programet e riintegritimit është ende i ulët dhe ka nevojë të rritet, fuqizohet dhe të shtrihet në të gjitha bashkitë. Krijimi i komuniteteve të profesionistëve në nivel vendor nuk është shtrirë tek të gjitha bashkitë. Për sa i përket forcimit të kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijët, pavarësisht trajnimeve të zhvilluara deri më sot, ka nevojë që të hartohen dhe të miratohen kriteret mbi trajnimin, licencimin, kreditimin e profesionistëve të ndryshëm⁶.

Paraprakisht hartimit të këtij protokollit është hartuar një analizë ligjore lidhur me procesin e riintegritimit të të miturve në konflikt me ligjin dhe koordinimin ndërinstytucional e cila kishte si qëllim:

- të sillte një panoramë të plotë të të gjithë hapave që duhen ndërmarrë dhe të përpjekjeve që duhen bërë, nga institucionet dhe profesionistët për të miturit, për të siguruar riintegrimin dhe rehabilitimin e të miturit dhe parandalimin e rikryerjes së një vepre penale nga ai;

⁶ Strategjia e Drejtësisë për të Mitur, 2022-2026, fq.20, https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Vendim-i-KM-892-DATE-27_12_2022.pdf

- të identifikonte, në varësi të fazës së procedimit penal dhe masës/dënimit që merret ndaj të miturit, institucionet dhe profesionistët përgjegjës për të siguruar riintegrimin dhe rehabilitimin e të miturit, si dhe nevojën për të bashkëpunuar dhe koordinuar përpjekjet;
- të identifikonte mangësitë dhe nevojat për përmirësim të kuadrit ligjor lidhur me procesin e riintegrit të të miturit si dhe masat që duhen ndërmarrë për të forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstytucional midis profesionistëve që punojnë me dhe për të miturit.

Analiza identifikoi disa problematika apo nevoja për përmirësime të mëtejshme për të adresuar një mbrojtje më të mirë të fëmijëve në konflikt me ligjin me fokus në përmirësimin e procesit të rehabilitimit/riintegrit të tyre në shoqëri. Përmbajtja e analizës dhe rekomandimet e identifikuar janë mbajtur në konsideratë gjatë hartimit të këtij protokollit pune me qëllim ofrimin e një panorame sa më të plotë të procesit të riintegrit të të miturit, të institucioneve përgjegjëse dhe të mënyrës së bashkëpunimit e koordinimit ndërinstytucional në kuadër të këtij procesi.

1. QËLLIMI I PROTOKOLLIT DHE PËRDORUESIT

1.1. QËLLIMI


Qëllimi kryesor i protokollit të punës është të identifikojë institucionet dhe profesionistët që përfshihen në procesin e riintegrit të të miturit në konflikt me ligjin, të qartësojë rolin dhe përgjegjësitë e secilit prej tyre në të gjitha fazat e procedimit penal, duke u mbështetur në parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi dhe në praktikën dhe modelet më të mira të riintegrit.

Protokollit ofron një panoramë të qartë dhe hap pas hapi të masave dhe veprimeve rehabilituese e riintegruese që mund të ndërmerren ndaj të miturit në konflikt me ligjin, si dhe të institucioneve përgjegjëse për realizmin dhe përmbushjen e tyre.

Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstytucional qëndron në themel të përpjekjeve për riintegrim të të miturit në konflikt me ligjin, ndaj edhe në këtë protokoll pune shpjegohet në varësi të masës, dënimit apo situatës në të cilën ndodhet i mituri, edhe mënyra se si realizohet bashkëpunimi e koordinimi ndërinstytucional. Mbështetur në modele të suksesshme të riintegrit të të miturve në konflikt me ligjin, protokollit pasqyron edhe veprimet, vlerësimet dhe parimet që duhet të mbahen konsideratë nga institucionet për të realizuar dhe ofruar në praktikë një proces riintegrit që përmbush qëllimin e kërkuar.

Në këtë këndvështrim, qëllimi i protokollit të punës është që të lehtësojë kuptimin nga përdoruesit e tij, jo vetëm të procesit të riintegrit të të miturit në konflikt me ligjin në faza të ndryshme të procedimit penal, por edhe të rolit që ata kanë në secilën fazë dhe të përmirësojë kështu bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstytucional. Gjithashtu, është e pritshme që protokollit i punës të kontribuojë në rritjen e efikasitetit në procesin e riintegrit të të miturit në konflikt me ligjin.

Së fundi, ky protokoll pune është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për të miturin në konflikt me ligjin dhe rrjedhimisht, në rast të përmirësimeve të ardhshme të këtij legjislacioni do të paraqitet nevoja për rishikimin e këtij protokoll. Gjithashtu, të paktën dy vjet pasi ky protokoll të jetë në zbatim nga institucionet, një vlerësim duhet bërë për të matur rezultatet e tij dhe për të identifikuar përmirësimet e mundshme.



1.2. PËRDORUESIT

Siç është theksuar, *përpjekjet për riintegrimin e të miturit duhet të fillojë sa më parë, që kur fëmija vjen në vëmendjen e autoriteteve pasi hyn në konflikt me ligjin*. Riintegrimi i të miturit në konflikt me ligjin parashikohet si një nga qëllimet e KDPM, i cili e trajton riintegrimin si një proces që nuk zbatohet vetëm ndaj të miturit të privuar nga liria por edhe në rastet e zbatimit të masave të shmangies nga ndjekja penale⁷ apo edhe më gjerësisht për të gjithë llojet e dënimeve ndaj të miturit që duhet të kenë si qëllim rishoqërimin, riintegrimin, rehabilitimin dhe parandalimin i rikryerjes së veprës penale ose i kryerjes së një vepre tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje⁸.

Në këtë kontekst, dhe *në varësi të masës, dënimit apo situatës në të cilën ndodhet i mituri në konflikt me ligjin, KDPM parashikon edhe përgjegjësitë dhe rolin e secilit institucion/profesionist në procesin e riintegrit të të miturit dhe mënyrën se si realizohet bashkëpunimi ndërinstytucional*. Shërbimet multidisiplinare janë të nevojshme për një metodë të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse të gjetjes së zgjidhjes më të përshtatshme për riintegrimin e fëmijës. Shërbimet multidisiplinare ofrohen gjatë menaxhimit të rastit, i cili është një proces i orientuar drejt rezultatit duke koordinuar një seri shërbimesh (mjekësore, sociale, arsimore, psikiatrike, ligjore etj). Një vendim i bazuar në të kuptuarin e përgjithshëm të fëmijës dhe situatës së tij kërkon vlerësim dhe ndërhyrje nga profesionistë të trajnuar në disiplina të ndryshme si psikolog, shërbime sociale, psikiatër, sistem arsimor, avokatët etj. Kur fëmija është subjekt i procedimit penal, atëherë këto shërbime asistojnë prokurorin/gjykatën gjatë

⁷ Neni 64 pika 6 i KDPM

⁸ Neni 93 i KDPM

vendimmarrjes në interesin më të lartë të fëmijës. Gjithashtu, në fazën e zhvillimit të planit të riintegritit/rishoqërimit për të miturin/të riun/të renë dhe zbatimin e tij, shërbimet multidisiplinare ofrojnë një qasje më përfshirëse që merr parasysh nevojat e ndryshme të fëmijës për t'u riintegruar në shoqëri.

Kështu, protokollin e punës i vjen në ndihmë çdo aktori që ka një rol në procesin e riintegritit të të miturit në konflikt me ligjin apo ushtron përgjegjësi në Sistemin e Integruar të Mbrojtjes së Fëmijës në konflikt me ligjin. Aktorë të tillë janë prokurorët, gjyqtarët, punonjësit e Shërbimit të Provës, punonjësit e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR), Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF), Institucionet e Ekzekutimit të Vendimit Penal (IEVP), policia e shtetit, punonjësit e shërbimit social, ndërmjetësit, psikologu, punonjësit social, punonjësit e shërbimit shëndetësor, punonjësit e arsimit, avokati mbrojtës, qendrat disiplinore/edukuese, organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në këtë fushë etj. Secili prej këtyre aktorëve ka mundësinë për të kuptuar rolin dhe përgjegjësitë e tij (menaxhuese apo mbështetëse) në procesin e riintegritit të të miturit në konflikt me ligjin.

Megjithatë dhe duke konsideruar rolin e rëndësishëm që kanë disa institucione e profesionistë si prokurori, gjyqtari, QPKMR, NJMF, Shërbimi i Provës dhe IEVP në procesin riintegruar të të miturit në konflikt me ligjin, një vëmendje më e madhe në këtë protokoll i është kushtuar pikërisht këtyre institucioneve.

Në tabelën më poshtë, janë identifikuar institucionet përgjegjëse si dhe profesionistët e tjerë të përfshirë në faza të ndryshme të procedimit penal dhe në procesin e riintegritit të të miturit.

Tabela 1: Institucionet përgjegjëse dhe profesionistët e tjerë të përfshirë në faza të ndryshme të procedimit penal dhe në procesin e riintegritit të të miturit

1. PROCEDIMI PENAL NDAJ TË MITURIT	
Faza 1: HETIMET PARAPRAKE	
Institucioni/profesionistët përgjegjës dhe roli i tyre	Institucioni/profesionistët e tjerë të përfshirë dhe roli i tyre
<p>Prokurori-ushtron ndjekjen penale/drejton hetimet.</p> <p>Punonjësi i policisë gjyqësore⁹</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ merr dijëni për veprat penale, me iniciativën e vet ose mbi kallëzim apo ankim; ✓ parandalon ose pengon pasojat e mëtejshme që rrjedhin nga vepra penale; ✓ kërkon autorët e veprave penale; ✓ kryen veprimet e nevojshme për të siguruar burimet e provës dhe për të grumbulluar gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal; ✓ kryen çdo hetim dhe veprim të urdhëruar ose të deleguar nga organi procedues; ✓ kryen veprime procedurale për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale etj. 	<p>Avokati</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ siguron mbrojtjen efektive të të miturit por edhe respektimin e të drejtave të tij gjatë procedimit penal; ✓ përfaqësimi i të miturit me avokat është i detyrueshëm gjatë gjithë hallkave të procedimit penal ndaj tij; ✓ avokatët duhet të jenë të specializuar në drejtësinë për të mitur, me përjashtim të rasteve kur i mituri ose përfaqësuesi i tij ligjor përzgjedh një avokat tjetër. <p>Psikologu</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ garanton, sipas rastit, mbështetjen psikologjike të të miturit dhe vlerëson thëniet e tij, në përputhje me zhvillimin mendor;

⁹ Neni 5 i Ligjit Nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”

Gjyqtari-shqyrton kërkesën e prokurorit për vleftësimin e arrestit/ndalimit dhe vendosjen e masës së sigurimit dhe merr vendim mbi kërkesën (brenda 48 orëve);

- ✓ prania e psikologut synon që të miturit t'i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur dhe t'i lehtësohet dhënia e dëshmisë nga ana e tij, duke bërë kujdes për të eliminuar frikësimin ose ndrojtjen e të miturit nga procesi;
- ✓ në çdo fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme;
- ✓ nëse është e mundur, sigurohet prania e të njëjtit psikolog gjatë gjithë procesit të drejtësisë penale për mitur;

Kujdes! Psikologu, i cili kryen rolin e mbështetësit emocional të fëmijës gjatë procesit të hetimit dhe gjykimin, nuk mund të caktohet nga gjykata për të marrë rolin e psikologut vlerësues të të miturit (pra, psikologu që përgatit vlerësimin psikologjik të të miturit në kuadër të përgatitjes së vlerësimit individual të tij).

NJMF/Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës

- ✓ plotëson nevojat e menjëhershme të të miturit në veshmbathje, higjienë, ushqim, etj.;
- ✓ merr të gjithë masat e nevojshme për të siguruar ofrimin e shërbimeve të nevojshme për të miturin;
- ✓ bashkëpunon me Shërbimin e Provës në kuadër të hartimit të vlerësimit individual të të miturit;
- ✓ siguron realizimin dhe mbikqyrjes e zbatimit të disa masave të shmangies.

Përkthyesi apo interpretuesi -ofron shërbimin e përkthimit për të miturit e huaj ose interpretim në gjuhën e shenjave nëse I mituri ka vështirësi në dëgjim, të folur, shikim etj.

Ndërmjetësi-prokurori gjatë hetimit të çështjes mund të propozojë ndërmjetësimin¹⁰ si masë shmangieje por edhe si një mundësi që çon në përmirësimin e marrëdhënieve midis të miturit autor dhe viktimës së veprës penale,¹¹

Organizatave ndërkombëtare dhe lokale-ofrojnë shërbime të ndryshme për të miturit, programe rehabilituese dhe riintegruese, etj.

Përfaqësuesi procedural

- ✓ i caktuar nga autoriteti procedues nga lista e dërguar nga NJMF, që do të kryejë përfaqësimin procedural të fëmijës në mungesë të përfaqësuesit të tij ligjor ose, në rast konflikti interesi mes tij dhe fëmijës;

¹⁰ Neni 3 pika 13 e KDPM

¹¹ Neni 64 pika 5 e KDPM

	<ul style="list-style-type: none"> ✓ ka të drejta përfaqësuese në emër të fëmijës në konflikt me ligjin, me qëllim për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës¹². <p>Punonjësi i paraburgimit-nëse ndaj të miturit gjykata vendos masën e sigurimit “arrest në burg”, atëherë i mituri vendoset pranë Institutit të të Miturve në Kavajë. Gjatë kësaj kohe dhe në varësi të nevojës, personeli i specializuar i Institutit të të Miturve në Kavajë do të ofrojë ndihmë sociale, edukative, psikologjike, mjekësore dhe fizike.</p> <p>Punonjësi i shërbimit të provës¹³</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ është përgjegjës për hartimin e vlerësimit individual të të miturit; ✓ mbikëqyr zbatimin e disa prej masave të shmangies; ✓ mbështet riintegrimin në shoqëri të të miturit. <p>Punonjësi social¹⁴ -pjesë e strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit dhe që kanë për detyrë identifikimin e nevojave, referimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve të individëve e të familjeve në nevojë. Të miturit në konflikt me ligjin janë pjesë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.</p> <p>Punonjësit e institucionit të specializuar të edukimit-institucioni ofron shërbim të specializuar për zbatimin e masës së shmangies për vendosjes nën kujdes të të miturit në një program edukativ dhe/ose korrigjues¹⁵. Instituti ofron kujdesin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të të miturit nga ana e një personi ose shërbimit të specializuar nëse kujdesi i prindit ose kujdestarit të të miturit, në rritjen, sjelljen dhe zhvillimin e personalitetit të tij nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur qëllimin e masave detyruese.</p> <p>Punonjësit e arsimit, mjekët, etj, të cilët në funksion të kompetencave ofrojnë mbështetje në procesin e zbatimit të masave të shmangies dhe në rehabilitim e të miturit.</p>
Faza 2: GJYKIMI I ÇËSHTJES	
Institucioni/profesionistët përgjegjës dhe roli i tyre	Institucioni/profesionistët e tjerë të përfshirë dhe roli i tyre
Gjyqtari	Prokurori -përfaqëson akuzën në emër të shtetit në gjyq;

¹² Neni 3, pika 12 të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve“ dhe neni 3, pika 17 të KDPM

¹³ Neni 13 i Ligjit nr.78/2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës”

¹⁴ Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

¹⁵ Neni 69 pika 2 e KDPM

<ul style="list-style-type: none"> ✓ i specializuar në drejtësinë penale për të mitur, i caktuar pranë seksioneve të posaçme për të miturit në gjykata; ✓ administron procesin gjyqësor ndaj të miturit. 	<p>Avokati- siguron mbrojtjen efektive të të miturit gjatë gjykimit;</p> <p>Psikologu- garanton mbështetjen psikologjike të të miturit;</p> <p>NJMF/PMF- merr të gjithë masat e nevojshme për të siguruar ofrimin e shërbimeve të nevojshme për të miturin; bashkëpunon me Shërbimin e Provës në kuadër të hartimit të vlerësimit individual të të miturit;</p> <p>Përkthyesi apo interpretuesi;</p> <p>Përfaqësuesi procedural në mungesë të prindit/kujdestarit ligjor;</p> <p>Punonjësi social;</p> <p>Ekspertë dhe profesionistë të tjerë, sipas nevojës, etj.</p>
--	---

Faza 3: EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË DËNIMIT JO ME BURGIM TË TË MITURIT

Institucioni/profesionistët përgjegjës dhe roli i tyre	Institucioni/profesionistët e tjerë të përfshirë dhe roli i tyre
<p>Prokurori-lëshon urdhrin për ekzekutimin e vendimit të gjykatës;</p> <p>Shërbimi i Provës-mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të dënimit jo me burgim; I raporton prokurorit mbi zbatimin e këtij vendimi;</p> <p>Kur gjykata cakton ndaj të miturit, një ose disa detyrime për t'u përmbushur¹⁶, organi kompetent që ndjek përmbushjen e detyrimit të dhënë ndaj të miturit caktohet në vendimin e gjykatës, duke mbajtur në konsideratë llojin e detyrimit. Një listë treguese e këtyre organeve, në nivel qendror dhe vendor, e shoqëruar me përgjegjësitë dhe procedurat e tyre, jepet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 207/201¹⁷.</p>	<p>Avokati, psikologu, përkthyesi apo interpretuesi, punonjësi social, drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, NJMF, Grupin Teknik Ndërsëktorial (GTN) në bashki, përfaqësuesi procedural, ekspertë dhe profesionistë të tjerë sipas nevojës, etj.</p> <p>Punonjësi përgjegjës pranë Shërbimit të Provës dhe organi kompetent që ndjek përmbushjen e detyrimit të dhënë nga gjykata ndaj të miturit do të bashkëpunojë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ institucionet qendrore si dhe vendore që ofrojnë shërbime për rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve; ✓ subjekte private, organizata të shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare, që punojnë në fushën e të drejtave të të miturve dhe shërbimeve në komunitet.

Faza 3: EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË DËNIMIT ME BURGIM TË TË MITURIT

Institucioni/profesionistët përgjegjës dhe roli i tyre	Institucioni/profesionistët e tjerë të përfshirë dhe roli i tyre
<p>Prokurori-lëshon urdhrin për ekzekutimin e vendimit të gjykatës;</p> <p>Instituti i të Miturve në Kavajë-mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të dënimit me burgim; I raporton prokurorit mbi zbatimin e këtij vendimi.</p>	<p>Avokati, psikologu, përkthyesi apo interpretuesi, punonjësi social, Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV)/NJMF, Policia e Shtetit, QPKMR, Shërbimi i Provës, përfaqësuesi procedural, ekspertë dhe profesionistë të tjerë sipas nevojës, etj.</p> <p>Punonjësi/t përgjegjës pranë Institutit të të Miturve në Kavajë do të bashkëpunojë me:</p>


¹⁶ Neni 102 i KDPM

¹⁷ VKM nr. 207, date 10.4.2019 "Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe të procedurës që do të ndiqet për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin", <http://ëëë.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2019/05/VKMNR22.pdf>

	<ul style="list-style-type: none"> ✓ institucionet qendrore përgjegjëse për arsimin, formimin profesional, punësimin, shëndetësinë, etj; ✓ NJQV me qëllim sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për të miturin dhe familjen e tij, strehimin, etj; ✓ subjekte private, organizata të shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare, që punojnë në fushën e të drejtave të të miturve dhe shërbimeve në komunitet.
2. PROCESI I RIINTEGRIMIT TË TË MITURIT PAS KRYERJES SË DËNIMIT MË BURGIM	
Institucioni/profesionistët përgjegjës dhe roli i tyre	Institucioni/profesionistët e tjerë të përfshirë dhe roli i tyre
<p>Instituti i të Miturve në Kavajë/NJMF e vendbanimit të të miturit dhe QPKMR- janë përgjegjëse për përgatitjen e planit të rishoqërizimit dhe rehabilitimit të të miturit në rast të lirimit të të miturit në përfundim të dënimit;</p> <p>Instituti i të Miturve në Kavajë/ Shërbimi i Provës/NJMF dhe QPKMR- janë përgjegjëse për përgatitjen e planit të rishoqërizimit dhe rehabilitimit të të miturit në rast të lirimit me kusht të tij;</p> <p>QPKMR dhe NJMF- janë institucionet përgjegjëse për koordinimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planit të rishoqërizimit dhe rehabilitimit të të miturit.</p>	<p>Punonjësi/t përgjegjës bashkëpunojë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ institucionet qendrore përgjegjëse për arsimin, formimin profesional, punësimin, shëndetësinë, etj; ✓ NJQV me qëllim sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për të miturin dhe familjen e tij, strehimin, etj; ✓ subjekte private, organizata të shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare, që punojnë në fushën e të drejtave të të miturve dhe shërbimeve në komunitet.

2. KUPTIMI I KONCEPTIT TË RIINTEGRIMIT TË TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Faktorët që kanë nxitur apo kontribuar që një i mitur të shkelë ligjin mund të shihen gjithashtu si faktorë që dobësojnë marrëdhëniet e tij dhe e përjashtojnë atë nga burimet që mbështesin një jetë të mirë dhe larg krimit. Shumicës së fëmijëve dhe të rinjve, të cilët shkelin ligjin, u mungon kujdesi dhe vëmendja e nevojshme nga familja e tyre. Kjo mund të jetë për shkak të mbikëqyrjes dhe disiplinës së dobët të prindërve, neglizhencës, abuzimit ose braktisjes, dhunës brenda familjes apo përfshirjes së anëtarëve të tjerë të familjes në krime etj. Këto vështirësi shpesh shoqërohen me rezultate jo të mira në shkollë ose përjashtim apo largim nga shkolla. Shpesh të miturit në konflikt me ligjin përballen me varfërinë dhe jetojnë në mjedise ku niveli i kriminalitetit është i lartë. Në këto kushte, të miturit e konsiderojnë shkeljen e ligjit si një nga zgjidhjet e pakta në dispozicion të tyre. Përfshirja e tyre në veprimtari jo të ligjshme i bën ata të fitojnë një reputacion brenda komunitetit të tyre dhe njëkohësisht, ata stigmatizohen nga mosmiratimi dhe mospranimi shoqëror që marrin për hir të veprimeve të tyre. Në mënyrë të pashmangshme këta të mitur bien në kontakt me sistemin e drejtësisë penale.



2.1.KUPTIMI I RIINTEGRIMIT

Riintegrimi i referohet procesit të ndërmarrë për t'i mundësuar një personi që të jetojë në shoqëri si një individ që zbaton ligjin përmes mbështetjes me shërbime të përshtatshme dhe pjesëmarrjes në programe të posaçme që diktojnë përshtatjen e një sjellje të re dhe të pranueshme të të miturit, duke zhvilluar më shumë kuptimin e përgjegjësive ligjore dhe morale, forcuar konceptin e rëndësisë së respektimit të të drejtave dhe lirive të të tjerëve, përmes promovimit të vlerave dhe aftësive të tij, duke nxitur dhe mundësuar zhvillimin e shëndoshë fizik, mendor, shpirtëror, edukativ, arsimor, moral dhe shoqëror të të miturit.

Lehtësimi i riintegrimit të të miturve në konflikt me ligjin është një detyrë komplekse dhe ndikimi i ndërhyrjeve specifike është shpesh i vështirë për t'u matur. Një qëllim i dukshëm i programeve të ri-integrimit është të inkurajojnë të miturit në konflikt me ligjin për të hequr dorë nga krimi dhe nga përfshirja e tyre në kryerjen e veprave penale. Një numër faktorësh janë të lidhur me përpjekjet për riintegrimit të të miturit të tillë si, përvetësimi i aftësive të reja, punësimi, përmirësimi i marrëdhënieve familjare e shoqërore, arsimimi, ofrimi i shërbimeve të ndryshme, etj.

Në KDPM, përkufizimin e konceptit të riintegritit të të miturit e gjejmë të përfshirë në përkufizimin e rishoqërizimit/rehabilitimit të tij, si një proces inkurajimi dhe zhvillimi, në kuptim të përgjegjësisë së të miturit, të ndjenjës së respektimit të të drejtave të të tjerëve, për të nxitur dhe mundësuar zhvillimin e shëndoshë fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të të miturit dhe për ta përgatitur atë që të rikthehet në shoqëri¹⁸.

Riintegrimi shpesh i referohet një procesi nëpërmjet të cilit një i mitur përgatitet që të ripërshtatet dhe ripërfshihet në jetën dhe mjedisin shoqëror, nga i cili është shkëputur përkohësisht për shkak të privimit të lirisë (mase sigurie apo dënim gjyqësor me burgim).

Megjithatë dhe pavarësisht tendencës së të kuptuarit të procesit të riintegritit si një proces që i dedikohet të miturit të privuar nga liria, KDPM adreson edhe nevojat për riintegrim të miturve në konflikt me ligjin të cilët nuk janë privuar nga liria (kur ndaj tyre merret masë alternative e shmangies apo dënim jo me burgim).

Promovimi i riintegritit të të miturit në konflikt me ligjin parashikohet si një nga qëllimet e KDPM, i cili e trajton riintegrimin si një proces që nuk zbatohet vetëm ndaj të miturit të privuar nga liria, por edhe në rastet e zbatimit të masave të shmangies nga ndjekja penale¹⁹ apo edhe më gjerësisht për të gjithë llojet e dënimeve ndaj të miturit që duhet të kenë si qëllim rishoqërizimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale ose i kryerjes së një vepre tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje²⁰.

2.2. STANDARDET MINIMALE NDËRKOMBËTARE TË RIINTEGRIMIT TË TË MITURVE NË KONFLIKT ME LIGJIN

Standardet ndërkombëtare të përcaktuara për sistemin e drejtësisë për të mitur përmbajnë sugjerime të fragmentuara lidhur me riintegrimin e fëmijëve në konflikt me ligjin. Më poshtë paraqiten, në mënyrë të përmbledhur, disa nga standardet minimale ndërkombëtare të riintegritit të të miturve në konflikt me ligjin.

Tabela 2: Standardet minimale ndërkombëtare të riintegritit të të miturve në konflikt me ligjin sipas burimit/akteve që i përcaktojnë

Burimi/Aktet	Standardet minimale ndërkombëtare
Rregullat minimale standarde të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur²¹	Ofrimin e ndihmës së nevojshme për të miturit "gjatë gjithë fazave të procedurës" siç janë strehimi, arsimi ose formimi profesional, punësimi ose ndonjë tjetër ndihmë e dobishme dhe praktike, me qëllim lehtësimin e procesit riintegrues.

¹⁸Neni 3, pika 21 i KDPM

¹⁹Neni 64 pika 6 i KDPM

²⁰Neni 93 i KDPM

²¹ Rregullat minimale standarde të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur ("Rregullat e Pekinit"), miratuar me rezolutën 40/33 të Asamblesë së Përgjithshme të 29 nëntorit 1985, pika 24.1, <https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/beijingrules.pdf>

Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e Grave të Burgosura ²²	Nevoja për programe të specializuara për ngritjen e kapaciteteve të personelit që lehtëson procesin e riintegritimit, rëndësinë e hartimit dhe zbatimit të programeve gjithëpërfshirëse të ri-integritimit gjatë dhe pas vuajtjes së dënimit të cilat marrin në konsideratë nevoja specifike gjinore, sigurimi i mbështetjes pas vuajtjes së dënimit (ndihmë psikologjike, mjekësore, juridike etj) për të siguruar që ri-integritimi të realizohet.
Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të miturit të privuar nga liria ²³ (1990)	Sigurimi i shërbimeve për të miturin, për aq sa është e mundur, si strehimi i përshtatshëm, punësimi, veshmbathje dhe mjete të mjaftueshme për të mirëmbajtur veten pas lirimit.
Udhëzimi për veprim ndaj të miturve në Sistemin e Drejtësisë Penale ²⁴	Nevoja për të miturin e privuar nga liria që të mbajë marrëdhëniet me familjen dhe komunitetin në mënyrë që të mos humbasin lidhjet shoqërore që do t'i ndihmonte ata në riintegritimin e tyre. Institucionet ku qëndron i mituri i privuar nga liria, duhet të krijojnë lehtësira në aksesin e familjarëve apo personave që kanë një interes të ligjshëm ndaj fëmijës, përveç kur nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.
Komenti i përgjithshëm Nr. 24 (2019) për të drejtat e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për të mitur ²⁵ , Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara	<p>Të shmanget mbajtja e regjistrave zyrtarë për të mitur në konflikt me ligjin pasi mund të pengojnë mundësitë për riintegritimin e tyre (strehim, arsim, punë, rrjet social).</p> <p>Reagimi ndaj një veprë penale duhet të jetë gjithmonë proporcional jo vetëm me rrethanat dhe rëndësinë e veprës penale, por edhe me rrethanat personale të të miturit (mosha, rrethanat, shëndeti mendor, nevojat e fëmijës etj), si dhe me nevojat e ndryshme dhe veçanërisht afatgjata të shoqërisë.</p> <p>Qasja rreptësishtë ndëshkuese nuk është në përputhje me parimet e drejtësisë për të mitur të shprehur në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Rëndësi parësore i duhet kushtuar interesit më të lartë të të miturit, si dhe nevojës për të promovuar riintegritimin e fëmijës në shoqëri.</p> <p>Trajtimi dhe kushtet e ofruara ndaj të miturit të privuar nga liria duhet që të mos komprometojë shëndetin e tyre, sigurinë, mirëqenien fizike, akomodimin, etj si dhe, rrjedhimisht, aftësinë e tyre të ardhme për të qëndruar larg krimit dhe për t'u riintegruar.</p> <p>Nevoja për zhvillimin e vlerësimeve të vazhdueshme, veçanërisht për të matur efektivitetin e masave të marra në lidhje me riintegritimin e të miturve në konflikt me ligjin, mundësisht të kryer nga institucione të pavarura akademike.</p>

Me miratimin e KDPM, një sistem i ri i drejtësisë penale për të miturit është parashikuar ku drejtësia miqësore për të miturit është në themel të tij. Korniza e re e drejtësisë penale për të mitur synon të jetë në përputhje me Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB)

²² Rregullat e Kombeve të Bashkuara për trajtimin e grave të burgosura (Rregullat Bangkok, 2011), Rezolutë e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në 21 Dhjetor 2010, rregulli 29,

https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Bangkok_Rules_ENG_22032015.pdf

²³ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria, miratuar me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 45/113 të 14 dhjetorit 1990, rregulli 80,

<https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/juvenilesdeprivedofliberty.aspx>

²⁴ Udhëzimi për veprim ndaj të miturve në sistemin e drejtësisë penale, të rekomanduara me rezolutën e Këshillit Ekonomik dhe Social 1997/30 të 21 korrikut 1997,

<https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CriminalJusticeSystem.aspx>

²⁵ Komenti i përgjithshëm Nr. 24 (2019) për të drejtat e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për të mitur, Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, Kombet e Bashkuara,


<http://docstore.ohchr.org/SelfServices/FilesHandler.ashx?enc=6QkG1d%2FPPRiCAqhKb7yhsqIkirKOZLK2M58RF%2F5F0vEnG3QGKUxFivhToQfjGxYjV05tUAIgpOëHQJsFPdJXCiixFSrDRëoë8HeKLLh8cgOë1SN6vJ%2Bf0RPR9UMtGkA4>

për të Drejtat e Fëmijës dhe standardet e normat e tjera ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit. Gjithashtu, ndër qëllimet që synon të përmbushë zbatimi i KDPM është edhe riintegrimi, rishoqërimi dhe rehabilitimi i të miturit në konflikt me ligjin me qëllim që ky i mitur të luajë në shoqëri një rol sa më të dobishëm.

2.3.PARIMET NGA TË CILAT UDHËHIQET PROCESI I RIINTEGRIMIT

Kuadri ligjor në fuqi, është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe sidomos me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, dhe parashikon një numër parimesh themelore. Çdo autoritet publik ka detyrimin që gjatë ushtrimit të detyrave të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të fëmijës në konflikt me ligjin, të njohura nga legjislacioni në fuqi, të zbatojë në mënyrë imperative parimin e interesit më të lartë të fëmijës në çdo proces administrativ apo gjyqësor, si dhe të kontribuojë në realizimin e tyre. Në mënyrë të veçantë, kur i mituri në konflikt me ligjin i nënshtrohet procesit penal, atëherë çdo person dhe çdo institucion i përfshirë është i detyruar të zbatojë parimet e drejtësisë penale për të mitur në të gjitha veprimet dhe vendimet e marra lidhur me të miturin. Ky detyrim përfshin edhe veprimet administrative që kryhen në kuadrin e drejtësisë penale për të mitur²⁶.

Edhe procesi i riintegritit të të miturit në konflikt me ligjin udhëhiqet nga parimet e sipërpërmendura, të cilat duhet të respektohen nga cilido që përfshihet në këtë proces. Kështu, KDPM²⁷ përcakton parime, që zbatohen në mënyrë të veçantë për të miturit në konflikt me ligjin, të cilët e kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale, si më poshtë:



²⁶ Neni 8 i KDPM

²⁷ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, nenet 8-18

Përveç parimeve të sipërpërmendura, profesionistët e drejtësisë për të mitur duhet respektojnë edhe parimet e të drejtat e parashikuara në Ligjin nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

3. REHABILITIMI DHE RIINTEGRIMI I TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

KDPM e trajton riintegrimin si një proces që nuk zbatohet vetëm ndaj të miturit të privuar nga liria por edhe në rastet e zbatimit të masave të shmangies nga ndjekja penale²⁸ apo edhe më gjerësisht për të gjithë llojet e dënimeve ndaj të miturit që duhet të kenë si qëllim rishoqërimin, riintegrimin, rehabilitimin dhe parandalimin e rikryerjes së veprës penale ose të kryerjes së një veprë tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje²⁹. Pra, procesi i riintegrit të të miturit shihet si një përpjekje e vazhdueshme dhe përgjatë gjithë procesit penal ndaj të miturit ku një sërë profesionistësh të drejtësisë për të mitur janë të përfshirë. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstytucional qëndron në themel të përpjekjeve për riintegrim të të miturit në konflikt me ligjin.

I mituri hyn në konflikt me ligjin kur ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri nën moshën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një veprë penale dhe është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e veprës penale³⁰. Të miturit që kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale, 14 vjeç në rastet e kryerjes së një krimi dhe 16 vjeç në rastin e kryerjes së një kundërvajtjeje penale dhe që nuk kanë mbushur ende moshën 18 vjeç do t'i nënshtrohen procedimit penal përmes sistemit të drejtësisë penale për të mitur.

Fëmijët që nuk kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale nuk i nënshtrohen procedimit penal dhe menaxhimi i rastit të të miturit bëhet vetëm nëpërmjet rrugës civile. Legjislacioni i zbatueshëm në këtë rast është ai për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Në këtë Protokoll trajtohet procesi i riintegrit të të miturve në konflikt me ligjin pra, i të miturve në moshën e përgjegjësisë penale, rasti i të cilëve menaxhohet nëpërmjet rrugës penale.

Qëllimi i rrugës penale ndryshon nga qëllimi i rrugës civile. Rruga penale synon të mbrojë sigurinë publike, duke identifikuar dhe duke vënë para përgjegjësisë penale autorin e veprës penale. Por, meqë ai (autori i veprës penale) është ende fëmijë, kjo rrugë synon edhe që ta mbështesë atë, duke pasur parasysh nevojat e tij, po ashtu edhe duke e riintegruar në mënyrë të suksesshme në shoqëri. I mituri, jo vetëm që gëzon tërë të drejtat për një proces sipas rregullave e ligjeve në fuqi, por, mbi të gjitha, edhe për të marrë mbrojtje të veçantë.

Përgjatë rrugës penale duhet të përmbushen disa objektiva. Kështu, duhet identifikuar shkalla e përgjegjësisë së të miturit dhe duhet gjetur masa më e përshtatshme që i shërben edukimit

²⁸ Neni 64 pika 6 i KDPM

²⁹ Neni 93 i KDPM

³⁰ Neni 3, pika 4 i KDPM

dhe rehabilitimit të tij. Gjithashtu, duhen bërë të gjitha përpjekjet për ekzekutimin e suksesshëm të masës që merret ndaj atij fëmije. Rruga penale ka gjithashtu, në qendër interesin më të lartë të fëmijës dhe të drejtat e tij të veçanta. Në përmbushje të këtij objekti, gjatë procesit penal kryhen vlerësimet individuale të të miturit, të cilat shërbejnë për t'i përshtatur nevojat e tij në programe edukimi dhe rehabilitimi në mënyrë që të bëhet i mundur riintegrimi i atij fëmije, duke e ulur kështu edhe mundësinë e përsëritjes së situatës së mëparshme. Por, nga ana tjetër, rregullat e KDPM-së synojnë ta rrisin edhe përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin e organeve kompetente në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur.



3.1.VEPRIMTARIA PARANDALUESE

Parandalimi është ndërhyrja në faza të hershme tek fëmijët në rrezikshmëri për të kryer vepra penale. Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve” e vendos punën parandaluese ndaj fëmijëve në qendër të mbrojtjes së tyre³¹ dhe ngre një sistem të integruar të mbrojtjes që ka për qëllim parandalimin dhe përgjigjen ndaj rreziqeve me të cilët përballen fëmijët³². Ligjit Nr. 18/2017 përfshin në kategorinë e fëmijëve në nevojë për mbrojtje edhe fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale që dyshohet se kanë kryer një veprë penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin duke i bërë kështu, pjesë e mbrojtjes ligjore të ofruar nga ky ligj.

Kështu, *Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF)* ka për detyrë të analizojë nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe të mbështetjes së familjeve me një fokus të veçantë tek parandalimi³³. *Bashkitë* gjithashtu, janë përgjegjëse zhvillimin e programeve dhe projekteve për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, për parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që vënë në rrezik jetën dhe integritetin moral, fizik, psikologjik e emocional të fëmijës.³⁴ *NJMF* ka për detyrë, në mënyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik

³¹ Neni 3, pika 8 të Ligjit Nr. 18/2017

³² Neni 3, pika 15 të Ligjit Nr. 18/2017

³³ Neni 41, pika 3/b të Ligjit Nr. 18/2017

³⁴ Neni 46/c të Ligjit Nr. 18/2017

dhe/ose në nevojë për mbrojtje³⁵. Ligjit Nr. 18/2017 parashikon rolin edukues dhe informues të NJMF në drejtim të identifikimit në moshë të hershme të fëmijëve në rrezik për të kryer vepra penale dhe, më tej, për t'u përfshirë në sistemin e drejtësisë penale për të mitur³⁶. Gjithashtu, në nenin 65 dhe nenin 66 të Ligjit Nr. 18/2017 parashikohet i njëjti rol i NJMF-së për fëmijët që nuk e kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale.

Aktivitetet parandaluese kanë për qëllim të ulin sa më shumë mundësinë e kryerjes së veprave penale nëpërmjet aktiviteteve edukuese dhe ndërgjegjësuere por edhe nëpërmjet përfshirjes së prindërve në programe këshillimi që e përmirësojnë prindërimin dhe ushtrimin e përgjegjësiave prindërore.

KDPM, i cili e ka vendosur qëllimin e parandalimit të ri-përfshirjes në krime të të miturve në qendër të politikës penale, ka parashikuar ngritjen e strukturave të posaçme të parandalimit të krimit tek të rinjtë dhe të rehabilitimit dhe riintegritimit nëpërmjet mbikëqyrjes dhe mbrojtjes të të miturit/të rinjve pas kryerjes së dënimit ose pas lirimit me kusht³⁷. Për këtë, pranë Ministrisë së Drejtësisë është krijuar **Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve**, e cila ushtron veprimtarinë parandaluese edhe nëpërmjet aktiviteteve dhe fushatave sensibilizuese në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit që do të mirëpresë të miturit pas përfundimit të periudhës së dënimit apo lirimit me kusht³⁸.

ASHDMF	<ul style="list-style-type: none"> •analizon nevojat për ndërhyrje specifike në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe të mbështetjes së familjeve me një fokus të veçantë tek parandalim
BASHKITË	<ul style="list-style-type: none"> •zhvillojnë programe dhe projekte për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, për parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që vënë në rrezik jetën dhe integritetin moral, fizik, psikologjik e emocional të fëmijës
NJMF	<ul style="list-style-type: none"> •ka për detyrë parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje •ka rol edukues dhe informues në drejtim të identifikimit në moshë të hershme të fëmijëve në rrezik për të kryer vepra penale dhe, më tej, për t'u përfshirë në sistemin e drejtësisë penale për të mitur
QPKMR	<ul style="list-style-type: none"> •ushtron veprimtarinë parandaluese edhe nëpërmjet aktiviteteve dhe fushatave sensibilizuese në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit që do të mirëpresë të miturit pas përfundimit të periudhës së dënimit apo lirimit me kusht

³⁵ Neni 49, pika 1 të Ligjit Nr. 18/2017

³⁶ Neni 49, pika 3/e të Ligjit Nr. 18/2017

³⁷ Neni 133, pika 4 i KDPM


³⁸ Vendim nr. 314, datë 15.5.2019 "Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve", <https://qpkmr.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/vendim-2019-05-15-314-perditesuar-1-1.pdf>

Për të siguruar efektivitetin e veprimtarisë parandaluese të institucioneve përgjegjëse duhet të përmbushen disa hapa të rëndësishëm si:

- ❑ Vlerësime dhe analiza të thella dhe periodike të kriminalitetit të të miturve dhe të të rinjve, të efikasitetit të programeve parandaluese, shërbimeve dhe burimeve të disponueshme;
- ❑ Hartimi i politikave penale dhe sociale të mbështetura në gjetjet e studimeve të kryera dhe të koordinuara midis institucioneve përgjegjëse;
- ❑ Krijimi i programeve parandaluese efektive mbështetur në studime dhe që përfshijnë metoda efektive për parandalimin e krimit tek të rinjtë;
- ❑ Përfshirja e të rinjve dhe komunitetit nëpërmjet një game të gjerë shërbimesh dhe programesh;
- ❑ Ndarja e qartë e përgjegjësisë midis institucioneve përgjegjëse në fushën e parandalimit të krimit tek të rinjtë;
- ❑ Forcimin e kapaciteteve profesionale dhe specializimi i stafit të institucioneve përgjegjëse në fushën e parandalimit të krimit tek të rinjtë;
- ❑ Forcimi i kapaciteteve në burime njerëzore dhe financiare të institucioneve përgjegjëse;
- ❑ Krijimi i mekanizmave të duhur për të siguruar bashkërendimin e përpjekjeve parandaluese ndërmjet institucioneve publike qendrore e vendore, përgjegjëse për parandalimin e krimit tek të rinjtë;
- ❑ Bashkëpunimi i ngushtë ndërdisiplinor ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat.

3.2. RIINTEGRIMI I TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN NË FAZA TË NDRYSHME TË PROCEDIMIT PENAL

Fëmijët, që kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale gjer në moshën 18 vjeç,³⁹ kur dyshohen se kanë kryer një veprë penale procedohen përmes sistemit të drejtësisë penale për të mitur. Ndaj këtyre të miturve fillon faza formale e procedimit penal e cila zhvillohet në tre faza: hetimet paraprake, gjykimi dhe dënimi si dhe ekzekutimi i masës/dënimit penal.



³⁹ Legjisllacioni shqiptar njeh tashmë edhe kategorinë e të rinjve të grup-moshës 18 deri në 21 vjeç, që akuzohen për kryerjen e një veprë penale kur kanë qenë të mitur, që kanë rregullim të posaçëm dhe të ndryshëm nga të rriturit mbi 21 vjeç. Megjithatë trajtimi i kësaj kategorie nuk është objekt i kësaj Analize.

Organet kompetente që veprojnë gjatë *fazës së hetimeve dhe masave paraprake* penale janë prokurori, që drejton hetimet, policia gjyqësore, që kryen të gjitha veprimet e deleguara e të urdhëruara nga prokurori dhe gjyqtari që mbikqyr dhe vleftëson veprimet hetimore dhe aktet proceduriale gjatë kësaj faze. Gjatë hetimeve, kur janë kushtet e caktuara nga ligji mund të vendoset edhe masë sigurimi, duke përfshirë edhe “arrestin në burg”. Katër janë vendimet që merr prokurori gjatë fazës së hetimeve paraprake (i.kërkesë në gjykatë për caktimin e masës së sigurimit, ii.vendim për pushimin e hetimit, iii. vendim për marrjes e masës alternative të shmangies dhe iv .paraqitja e kërkesës pranë gjykatës për fillimin e gjykimit).

Gjatë fazës së *gjykimit*, kur masa alternative e shmangies nuk është vendosur nga prokurori, atëherë gjykata mund të vendosë kthimin e çështjes prokurorit për të proceduar me zbatimin e masës së shmangies. Gjithashtu, gjykata mund të marrë vendim për dënimin e të miturit apo pafajësinë e tij. Dënimet që mund të merren ndaj një të mituri janë dënimet jo me burgim dhe dënimi me burgim. Vendimi i gjykatës ndaj të miturit mund të jetë: vendim për pushimin e çështjes, vendim për shpalljen e të pandehurit të pafajshëm ose vendim fajësie dhe dënimi.

Vendime të tilla si ai i pafajësisë, ai i pushimit të çështjes apo i kthimit të çështjes prokurorit për të proceduar me zbatimin e masës së shmangies janë vendime me ekzekutim të menjëhershëm. Vendimet e dënimin për të miturit janë vendime dënimi jo me burgim dhe vendime dënimi me burgim. Vendimi penal vihet në ekzekutim kur merr formë të prerë me anë të urdhrin për ekzekutim që lëshon prokurori. *Ekzekutimi i vendimit* të dënimin jo me burgim ose i lirimit me kusht të të miturit zbatohet nga Shërbimi i Provës⁴⁰. I mituri vazhdon të vuajë dënimin jo me burgim ose me kusht të përcaktuar në vendimin e dënimin si i mitur edhe nëse ka mbushur moshën 18 vjeç para fillimit të ekzekutimit ose gjatë ekzekutimit të këtij vendimi. Kur gjykata cakton ndaj të miturit në konflikt me ligjin, një ose disa detyrime për t’u përmbushur, organi kompetent që ndjek përmbushjen e detyrimit të dhënë ndaj të miturit caktohet në vendimin e gjykatës, duke mbajtur në konsideratë llojin e detyrimit. Një listë treguese e këtyre organeve, në nivel qendror dhe vendor, e shoqëruar me përgjegjësitë dhe procedurat e tyre, jepet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 207/2019⁴¹. Kur ndaj të miturit është marrë nga gjykata vendimi me burgim atëherë prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit dhe i mituri vendoset në seksione/institucione të posaçme të vuajtjes së dënimin për të mitur.

3.2.1. Vlerësimi individual i të miturit në faza të ndryshme të procedimit penal

KDPM parashikon vlerësimin individual të të miturit në çdo fazë të procedimit penal.

⁴⁰ Neni 107 i KDPM

⁴¹ VKM nr. 207, date 10.4.2019 “Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe të procedurës që do të ndiqet për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin”, <http://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/05/VKMNR22.pdf>

Vlerësimi i të miturit në faza të ndryshme të procedimit penal është një proces i rëndësishëm që përcakton elementët që duhen mbajtur në konsideratë gjatë këtij procesi lidhur me të miturin por edhe mbi të cilat mbështeten masat riintegruese që do të zbatohen ndaj tij.

Gjatë fazës së hetimit dhe gjykimit, gjykata ose prokurori, përpara marrjes së ndonjë vendimi mbi të miturin, do të kërkojë nga ekspertë/grup ekspertësh, vlerësimin e rrethanave individuale, shëndetësore, familjare, sociale dhe mjedisore të të miturit në mënyrë që të kuptojë personalitetin, niveli i përgjegjshmërisë dhe shkallën e përgjegjësisë së tij në kryerjen e veprës penale (neni 22 KDPM).

Në rastet e nivelit të ulët të përgjegjshmërisë për shkak të sëmundjeve mendore, i mituri referohet për vlerësim psikiatriko-ligjor të mëtejshëm, si kusht për përjashtimin e tij nga përgjegjësia penale dhe vendosjen me vendim gjykate në një institucion mjekësor të pavarur dhe të specializuar.

Prokurori/gjykata kërkojnë në mënyrë të detyrueshme përgatitjen dhe mbajtjen parasysht të raportit të vlerësimit individual kur:

- a) përcaktohet masa alternative e shmangies;***
- b) caktohet lloji i dënimit;***
- c) ekzekutohet vendimi i dënimit; si dhe***
- ç) shqyrtohet kërkesa për lirim me kusht.***

Përveç këtij parashikimi të përgjithshëm, KDPM shkon edhe mëtej në kërkesat e tij duke parashikuar kushtet dhe premiset mbi të cilat duhet të mbështeten gjykata dhe prokuroria për të konkluduar në evidentimin e personalitetit të të miturit dhe përcaktimin e nevojave të tij.

Prokurori/gjykata në procesin e vlerësimit të të miturit dhe ***për të konkluduar në evidentimin e personalitetit të të miturit dhe përcaktimin e nevojave të tij, mbështetet në⁴²:***

- ***nivelin e zhvillimit;***
- ***mënyrën e jetesës;***
- ***edukimin dhe kushtet e zhvillimit;***
- ***arsimimin;***
- ***gjendjen shëndetësore;***
- ***mjedisin familjar dhe***
- ***kushtet e tjera të të miturit, të cilat e lejojnë për të vlerësuar karakteristikat e personalitetit të të miturit, të sjelljes dhe të nevojave të tij, përfshirë edhe nevojat e veçanta”.***

Krahas sa më lart, hartimi i një raporti për vlerësimin individual të të miturit kryhet jo vetëm për të pasqyruar të gjithë të dhënat e sipërpërmendura, ***por edhe për të përshkruar:***

- ***nevojat e veçanta të të miturit;***

⁴² Neni 47 i KDPM

- *rrezikun e përsëritjes së veprës penale, si dhe*
- *elementë të tjerë në varësi të rrethanave individuale, duke*
 - *rekomanduar masat e duhura të trajtimit, dënimit dhe rehabilitimit për të nxitur zhvillimin, përshtatjen dhe riintegrimin e tij në shoqëri,*
 - *duke minimizuar sa më shumë riviktimizimin dhe*
 - *ripërfshirjen si faktorë të lartë risku në fushën e kriminologjisë.*

Raporti i vlerësimit individual të të miturit shihet si i domosdoshëm në të gjitha rastet kur gjykata ose prokurori janë para detyrës për përcaktimin e masës alternative të shmangies ose të llojit të dënimit, sepse në varësi të karakteristikave individuale të të miturit, të rrezikshmërisë së tij shoqërore, të mundësisë së të miturit për t'u rehabilituar caktohet nëse do të vendoset shmangia e tij nga ndjekja penale, dhënia e një alternative dënimi jo me burgim apo vendosjen e kufizimit të lirisë së të miturit. Në varësi të kësaj, gjykata ose prokurori do të vendosin mënyrën e ekzekutimit të vendimit të dënimit ose do vendosin nëse do të pranojnë ose jo kërkesën për lirim me kusht⁴³.

Është gjykata dhe prokurori, që në varësi të rastit dhe të llojit të masës apo dënimit që parashikohet të merret ndaj të miturit, do të caktojnë se kush do të jetë përgjegjës për përgatitjen e këtij vlerësimi.

Gjykata/prokurori përpara marrjes së vendimit për përcaktimin e masës alternative të shmangies ose të llojit të dënimit kërkojnë përgatitjen e një raporti të vlerësimit individual të të miturit nga eksperti/grupi i ekspertëve të caktuar prej tyre ose nga Shërbimi i Provës⁴⁴.

Dispozitat e KDPM duhet të lexohen së bashku me dispozitat e ligjit nr. 78/2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës”⁴⁵, ligjit nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” si dhe me parashikimet e Rregullores së Përgjithshme të Shërbimit të Provës⁴⁶. Në nenin 18 të ligjit nr. 78/2020 parashikohet se Shërbimi i Provës, me kërkesë të prokurorit ose të gjykatës, paraqet raportin e vlerësimit për të miturin në konflikt me ligjin gjatë fazës së hetimeve paraprake, përpara dhënies së masës alternative të shmangies nga ndjekja penale, gjatë gjykimit përpara dhënies së vendimit penal si dhe gjatë fazës së ekzekutimit për rastet e parashikuara nga ligji.⁴⁷ Raporti duhet të përmbajë edhe rekomandimin e Shërbimit të Provës për masat e nevojshme për tu ndërmarrë për të nxitur zhvillimin dhe integrimin e të miturit në shoqëri.

⁴³ Neni 47 i KDPM, Komentari Elektronik, <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2017/37/47>

⁴⁴ Neni 47 pika 6 e KDPM

⁴⁵ Neni 18 i ligjit nr. 78/2020

⁴⁶ VKM nr.421, datë 8.7.2021

⁴⁷ ç) gjatë fazës së ekzekutimit në rastet e:

i. mbikëqyrjes së të dënuarit të vënë në provë;

ii. shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht;

iii. përfundimit para kohe të periudhës së vënies në provë;

iv. përfundimit të dënimit alternativ apo përfundimit të përmbushjes së detyrimeve të caktuara;

v. mospërmbushjes së detyrimeve nga personi nën mbikëqyrje;

Kështu, në rastet kur ekzekutohet vendimi i dënimit dhe në varësi të llojit të dënimit (dënim me burgim/dënim jo me burgim) ose kur shqyrtohet kërkesa për lirim me kusht, ky raport përgatitet nga IEVP dhe/ose Shërbimi i Provës.

- ❖ kur ekzekutohet vendimi i dënimit me burgim, institucion përgjegjës për hartimin e raportit të vlerësimit individual të të miturit është IEVP;
- ❖ kur ekzekutohet vendimi jo me burgim apo kur shqyrtohet kërkesa për lirim me kusht të të miturit, institucion përgjegjës është Shërbimi i Provës.

Vlen të theksohet se në të gjithë situatat e sipërpërmendura, sipas rastit, merret edhe mendimi i NJMF-së të juridiksionit ku ka vendbanimin i mituri⁴⁸. Ligjvënësi përdor shprehjen "sipas rastit", për të lënë të kuptohet se mendimi i NJMF-së nuk është i detyrueshëm, por vlerësohet rast pas rasti nga gjykata, prokuroria ose nga institucionet dhe ekspertët që përgatisin raportin e vlerësimit. NJMF mund të përcjellë të dhëna të rëndësishme për procesin e vlerësimit lidhur me situata të mëparshme të menaxhimit të të miturit, gjendjen ekonomike, familjare, dhe komunitare të tij.

Gjatë kryerjes së vlerësimit individual të të miturit, eksperti ose grupi i ekspertëve, përfaqësuesi i Shërbimit të Provës, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale ose, sipas rastit, Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, takohet lirisht me të pandehurin e mitur dhe merr të gjithë informacionin e nevojshëm nga çdo person fizik ose/dhe juridik publik ose/dhe privat që e konsideron si ndihmës në këtë proces⁴⁹. Shprehja "***takohet lirisht me të pandehurin e mitur***" duhet kuptuar se hartimi i raportit individual bëhet pa e kufizuar veten ose të miturin, pa u shtrënguar nga të tjerët, me vullnet të lirë, pa pengesë, pa druajtje, në mënyrë të lirë e të pavarur. Për këtë bëhet kompromis në favor të interesit të të miturit si për shembull, caktimi i ambjentit, orarit, frekuencës së takimeve etj, pa cenuar cilësinë dhe vërtetësinë e raportit⁵⁰. Nëse i mituri nuk flet dhe nuk kupton gjuhën shqipe, atij i duhet siguruar një përkthyes. Takimi zhvillohet në praninë e detyrueshme të prindit/kujdestarit ligjor, mbrojtësit dhe psikologut apo, kur është e nevojshme, në praninë e personave apo të përfaqësuesve të institucioneve, të cilëve u është besuar mbikëqyrja e të miturit. Gjithashtu, takimi zhvillohet në ambiente miqësore për fëmijët.

Punonjësi/eksperti/ët përgjegjës për kryerjen e vlerësimit individual ***i sigurojnë të miturit të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me intervistimin e tij***, si:

- ✓ qëllimin e intervistës;
- ✓ mënyrën se si do të zhvillohet intervista;
- ✓ faktet dhe rrethanat që do të diskutohen gjatë intervistës;
- ✓ kohëzgjatja;
- ✓ për informacionet që do të mblidhen nga burime të tjera;
- ✓ që çdo gjë që i mituri thotë gjatë intervistës mund të përdoret për qëllimet e vlerësimit dhe të paraqitet në raportin e vlerësimit që do të përcillet prokurorit/gjykatës dhe do të jetë pjesë e dokumentacionit;

⁴⁸ Neni 47 pika 6 i KDPM dhe neni 19 i ligjit nr. 78/2020

⁴⁹ Neni 47 pika 7 i KDPM

⁵⁰ Neni 47 i KDPM, Komentari Elektronik, <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2017/37/47>

- ✓ respektimin e parimit të konfidencialitetit;
- ✓ pjesëmarrjen në hartimin e raportit përpara përfundimit;
- ✓ të drejtën që gjatë intervistës të shprehë lirisht mendimin dhe të jetë pjesë aktive e gjetjes së zgjidhjes më të mirë.

Megjithatë, punonjësi/eksperti/ët përgjegjës për kryerjen e vlerësimit individual të të miturit duhet të përpiqen të kufizojnë numrin e takimeve në mënyrë që të mos ta ekspozojë atë ndaj stresit. I mituri ka të drejtën të marrë pjesë në hartimin e raportit të vlerësimit dhe të japë mendimin e tij lidhur me përmbajtjen e raportit përpara se të jetë përfunduar.

Për mbledhjen e të dhënave/informacioneve të nevojshme, punonjësi/eksperti/ët përgjegjës për kryerjen e vlerësimit individual:

- ✓ kontakton çdo person dhe institucion që mund të ofrojë informacion të dobishëm rreth arsimit, punësimit, strehimit, sjelljes, shëndetit, rrethanave shoqërore e familjare të të miturit;
- ✓ bashkëpunon me çdo institucion shtetëror, ent publik ose subjekt privat për vjeljen e informacionit të nevojshëm;
- ✓ kontakton anëtarë të familjes, persona nga institucionet arsimore apo vendi i punës dhe çdo person tjetër që mund të ofrojë informacion të dobishëm;
- ✓ vlerëson nëse nevojitet një analizë komplekse dhe të specializuar psikologjike, sociologjike, pedagogjike, mjekësore etj me qëllim që të mbështetet me ekspertizën e duhur për të hartuar raportin e vlerësimit.

Prokurori/gjykata bën kujdes që afati i përgatitjes së raportit të mos bëhet pengesë për ecurinë dhe afatet e çështjes penale konkrete⁵¹. ***Afati për përgatitjen e raportit të vlerësimit individual*** përcaktohet nga gjykata/prokurori në rastin kur përgatitja e raportit do të kryhet nga ekspertë/grup ekspertësh apo I EVP. Kur raporti i vlerësimit do të përgatitet nga Shërbimi i Provës, afati për përgatitjen e tij është jo më vonë se 14 ditë nga marrja e kërkesës nga gjykata/prokurori. Në rast pamundësie objektive për hartimin e raportit të vlerësimit brenda afateve të përcaktuara nga prokuroria ose gjykata, ose kur për hartimin e raportit kërkohen të dhëna shtesë, që bëjnë të nevojshëm shtyrjen e afateve, Shërbimi i Provës njofton prokurorin ose gjykatën për pamundësinë e hartimit të raportit të vlerësimit në afatin e përcaktuar duke parashtruar edhe arsyet përkatëse. Në çdo rast Shërbimi i Provës harton raportin e vlerësimit jo më vonë se 7 ditë nga dita e njoftimit të arsyeve të shtyrjes⁵².

Raporti i vlerësimit individual mbahet në konsideratë në çdo fazë të procedimit penal.


Informacioni i dhënë në një raport të mëparshëm merret parasysh në procesin e përgatitjes së një raporti tjetër të vlerësimit individual në çdo fazë të mëtejshme të procedimit penal. Pra thënë në mënyrë më të qartë raporti i vlerësimit individual plotësohet dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazave të ndryshme të procedimit penal.

⁵¹ Neni 47 pika 5 i KDPM


⁵² Neni 18 i ligjit nr. 78/2020

Mbi bazën e vlerësimeve të mësipërme, dhe pas marrjes së masës/dënimit ndaj të miturit, institucioni mbikëqyrës i zbatimit të masës/dënimit harton **Planin e Trajtimit Individual** të të miturit. Ky plan identifikon dhe tregon shërbimet që i duhen ofruar të miturit dhe masat e nevojshme që duhen ndërmarrë për të siguruar rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturit në shoqëri. Plani i Trajtimit Individual duhet të jetë një plan fleksibël dhe realist dhe duhet të lidhet me faktorë që do të zvogëlojnë riskun e ripërfshirjes së të miturit në kriminalitet. Plani parashikon se ku do të fillojë dhe si do të bëhet ndërhyrja me të miturin. Është thelbësore që i mituri të përfshihet përgjatë gjithë hartimit të planit, në mënyrë që ky i fundit të angazhohet në proces dhe për rrjedhojë, të përfshihet në marrjen në konsideratë të veprimeve të nevojshme për të zvogëluar rrezikun e recidivimit.

Plani i Trajtimit Individual përmban parashikime që kanë të bëjnë me nevojat e identifikuarat si, historiku i sjelljes antisociale, modeli i personalitetit antisocial, qëndrime prokriminale, shoqëria prokriminale, shkollimi/punësimi, familja/marrëdhëniet, koha e lirë/rekreacioni, abuzimi me substanca. Gjithashtu, plani duhet të identifikojë nevojat për ndërhyrje dhe të parashikojë, në mënyrë të detajuar, ndërhyrjet/shërbimet/masat që duhen marrë për të përmbushur këto nevoja duke identifikuar gjithashtu, edhe institucionet apo subjektet përgjegjëse për realizimin e tyre dhe afatet.



Më poshtë paraqesim në mënyrë skematike institucionet përgjegjëse në procesin e hartimit të raportit të vlerësimit individual të të miturit në faza të ndryshme të procedimit penal (Skema nr.1).



3.2.2. Zbatimi i masës alternative të shmangies

Shumica e të miturve përballen me vështirësi të konsiderueshme që lidhen me stigmën familjare, sociale dhe marginalizimin. Kjo bën që ata të përballen me vështirësi në gjetjen e vendit të tyre në shoqëri përmes arsimit ose punësimit dhe të një mjedisi familjar të qëndrueshëm dhe të sigurtë. Riintegrimi nuk ka të bëjë vetëm me kujdesin ndaj të miturit kur ai del nga sistemi i drejtësisë penale. Riintegrimi duhet të fillojë sa më parë, që kur i mituri vjen në vëmendjen e institucioneve të drejtësisë penale për të mitur, të cilët duhet të mbajnë në konsideratë mundësinë e integritit të hershëm të tij ndërsa i mituri është ende në kontakt me sistemin e drejtësisë⁵³. Riintegrimi duhet të jetë një shqetësim i përbashkët dhe qëllim kolektiv i të gjithë profesionistëve të përfshirë në drejtësinë për të mitur nga dita e parë e kontaktit të një fëmije në konflikt me ligjin. Megjithatë masat dhe veprimet që ndërmerren dhe institucionet që përfshihen për kordinimin e veprimeve në menaxhimin e rastit variojnë në varësi të masës/ dënimit që merret ndaj të miturit.

Në rast se ndaj të miturit zbatohet masa alternative e shmangies, atëherë procesi i riintegritit të të miturit fillon që në fazën që procesi penal administrohet nga prokurori apo gjyqtari për këtë qëllim.

Masat alternative që synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese duhet të vlerësohen si mundësia e parë. Këto mënyra për zgjidhjen e çështjes në ngarkim të të miturit fokusohen më shumë tek rishoqërimi dhe rehabilitimi i të miturit. Fokusi nuk duhet të jetë vetëm tek shkaqet që e çuan fëmijën në këtë situatë, duke propozuar ndërhyrje të orientuara në trajtimin e tyre, por edhe në tejkalimin e pengesave për riintegrim.

Zbatimi i masës së shmangies mund të kërkohet:

- ✚ nga vetë prokurori me iniciativën e tij, deri në momentin para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes. Nëse ti ose prindërit e tu jepni pëlqimin me shkrim për zbatimin e saj, atëherë prokurori do të lidhë një marrëveshje me ty për llojin e masës së shmangies që do të zbatohet;
- ✚ me kërkesën e të miturit ose të prindit/kujdestarit;
- ✚ nga gjykata me iniciativën e saj ose me kërkesë të palëve, punonjësit social ose psikologut. Në këtë rast, dhe pasi merr pëlqimin e të miturit, Gjykata mund të vendosë kthimin e çështjes prokurorit për të proceduar me zbatimin e masës së shmangies.

Para marrjes së vendimit për zbatimin e masës së shmangies, gjyqtari/prokurori mund të kërkojë informacion nga prindërit, kujdestarët ligjorë, institucionet që kanë dijeni për veprimtarinë e të miturit, përfshirë, sipas rastit, edhe NJMF-në, si dhe mendimin e ekspertit, sipas nevojave të të miturit dhe të procesit. Në rastin kur i mituri jep pëlqimin⁵⁴ dhe prokurori vendos për zbatimin e

⁵³ Neni 24.1 i Rregullave të Pekinit "ndihma e nevojshme duhet t'u ofrohet të miturve në të gjitha fazat e procedurës".

⁵⁴ Neni 56 pika 3 e KDPM

saj, atëherë prokurori merr vendimin për mosfillimin e çështjes penale ose pushimin e saj dhe lidh një marrëveshje⁵⁵ me të miturin për llojin e masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimin⁵⁶.

Masat alternative për shmangien nga ndjekja penale mund të përfshijnë⁵⁷:

- a) programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi;
- b) këshillimin për të miturin dhe familjen;
- c) paralajmërimin me gojë;
- ç) paralajmërimin me shkrim;
- d) masat detyruese;
- dh) vendosjen nën kujdes.

Ndaj të miturit mund të zbatohen në të njëjtën kohë disa masa alternative. Këto masa përcaktohen mbështetur në raportin e vlerësimit individual të të miturit. Masat e shmangies duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me nevojat e të miturit në konflikt me ligjin dhe të viktimës.

Në çdo rast, ***masa e shmangies zbatohet nëse***⁵⁸:

- a) ka prova të mjaftueshme për një dyshim të arsyeshëm se i mituri ka kryer një veprë penale, për të cilën parashikohet dënim me burgim deri në 5 vjet në maksimum ose me gjobë;
- b) i mituri pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit;
- c) i mituri nuk është kallëzuar për kryerjen e një veprë penale ose nuk është përsëritës;
- ç) i mituri dhe, sipas rastit, përfaqësuesi i tij ligjor ose procedural japin pëlqimin me shkrim për zbatimin e shmangies;
- d) i mituri nuk ka marrë pjesë më parë në një program ku të jetë zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale dhe/ose e ndërmjetësimi;
- dh) dënimi i të miturit për ato vepra nuk i shërben korigjimit të sjelljes së tij;
- e) duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të të miturit, shihet nëse nuk ka një interes publik për fillimin e ndjekjes penale ose vazhdimin e ndjekjes penale të filluar

a. Programet e drejtësisë restauruese dhe/ose ndërmjetësimi

Programet e drejtësisë restauruese dhe/ose ndërmjetësimi kanë si qëllim krijimin e mundësive për të miturin që të korigjojë pasojat e veprës penale të kryer prej tij ndaj viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë.


⁵⁵ Urdhër i Ministrisë së Drejtësisë nr.7641, datë 5/07/2018 “Për përcaktimin e elementeve të marrëveshjes për zbatimin e masës së shmangies dhe/ose ndërmjetësimin”, https://drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/Urdher_percaktimi-i-elementeve-te-marreveshjes-per-zbatimin-e-mases-se-shmangies_ndermjetesimit_KDPM.pdf

⁵⁶ Neni 58 pika 3 e KDPM

⁵⁷ Neni 62 i KDPM

⁵⁸ Neni 55 pika 3 i KDPM

Korrigjim i pasojave të veprës penale nënkupton çdo lloj veprimi që sjell si pasojë një atmosferë më të mirë sociale, fizike e psikologjike për të miturin e përfshirë në një proces të drejtësisë penale për të mitur, të tilla si përmirësimi i shëndetit mendor e fizik të të miturit, rishoqërimimi më i shpejtë në mjedisin publik, frekuentimi i shkollës dhe i jetës së mëparshme sociale, rregullimi i raporteve familjare dhe shoqërore, stabiliteti në jetën private e personale, e të tjera⁵⁹.



Programet e drejtësisë restauruese janë programe që zhvillohen dhe ndiqen nga organet publike dhe subjektet private për të mbështetur integritimin dhe rehabilitimin e të miturve të akuzuar për kryerjen e një veprë penale. Këto programe bëhen pjesë e procedurave të drejtësisë penale për të mitur, por në çdo rast ato do të zhvillohen jashtë procesit gjyqësor apo hetimor⁶⁰.


⁵⁹ Neni 63 i KDPM, Komentari Elektronik, <http://komentarielektronik.magjistatura.edu.al/sq/eli/fz/2017/37/47>

⁶⁰ Neni 3 pika 12 e KDPM



*Ndërmjetësimi*⁶¹ *si masë shmangieje*, mund të propozohet nga prokurori gjatë hetimit dhe gjyqtari gjatë gjykimit, nëse vlerësojnë se kjo alternativë është më e përshtatshme, duke pasur parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historinë e të miturit, mundësinë e kthimit të raporteve normale mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësinë e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimin e tij në shoqëri. Ky parashikim reflekton detyrimin e gjykatës dhe prokurorit, sipas nenit 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, që të vlerësojnë nëse ndërmjetësimi është alternativa më e mirë. Në rast se, pas propozimit të prokurorit/gjyqtarit palët bien dakort të zgjidhin çështjen me ndërmjetësim, atëherë procesi gjyqësor apo hetimor pezullohet për 45 ditë për të vijuar procedurën e ndërmjetësimit jashtëgjyqësisht. Nëse marrëveshja e ndërmjetësimit arrihet, prokurori/gjyqtari vendos pushimin e çështjes. Nëse marrëveshja e ndërmjetësimit nuk arrihet me kalimin e 45 ditëve, pezullimi bie dhe vazhdon hetimi/gjykimi i çështjes.

⁶¹ Neni 3 pika 13 e KDPM “Ndërmjetësimi është procesi i zgjidhjes jashtëgjyqësisht dhe përmes dialogut mes një të mituri që ka kryer veprën penale dhe viktimës, i cili realizohet nga ndërmjetësi dhe synon të zgjidhë mosmarrëveshjen mes tyre dhe pasojat që vijnë nga vepra penale, si dhe të përmirësojë marrëdhëniet midis tyre, pavarësisht nëse zbatohet ose jo si masë shmangieje”.



KDPM referon gjithashtu, në Ligjin nr. 10835, datë 24.2.2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" i cili rregullon procesin e ndërmjetësimit dhe përmban parashikime lidhur me ndërmjetësimin në çështjet penale dhe me të mitur.


Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas rastit, *mund të zbatohet edhe si masë shmangieje por edhe si një mundësi që çon në përmirësimin e marrëdhënieve midis të miturit autor dhe viktimës së veprës penale*⁶². Pra, ndërmjetësimi edhe kur nuk ka efekte të tilla që sjellin shmangien nga ndjekja penale mund të zbatohet për të përmirësuar marrëdhëniet midis viktimës

⁶² Neni 64 pika 5 e KDPM

dhe të aktuzuarit si një proces më vete që inicohet me dëshirën dhe zgjedhjen e lirë të palëve. Megjithatë, mundësia e zbatimit të ndërmjetësimit si një masë shmangieje nga ndjekja penale do të thotë që realizimi me sukses i procedurës së ndërmjetësimit do të kishte si pasojë mosfillimin e procedimit penal, pezullimin apo pushimin e tij duke sjellë si rezultat mungesën e përgjegjësisë penale të të miturit të akuzuar për kryerjen e veprës penale, gjë që është mundësia më e mirë që ai të riintegrohet dhe rehabilitohet nga pikëpamja sociale.

Ndërmjetësimi si procedurë jashtëgjyqësore **zhvillohet nën drejtimin e një personi të tretë që është ndërmjetësi i licencuar⁶³ dhe zhvillohet vetëm nëse ekziston pëlqimi i lirë për ndërmjetësim i shprehur si nga i mituri i akuzuar për veprën penale dhe nga pala e dëmtuar dhe pjesëmarrjes së detyruar të tyre.** Vendi, koha dhe mënyra e zhvillimit të këtij procesi kryhet në ambiente asnjëanëse për të cilat palët dhe/ose autoritetet e drejtësisë bien dakort.

KDPM parashikon mundësinë e pjesëmarrjes së personave të tjerë⁶⁴, përveç palëve, në procesin e ndërmjetësimit dhe pjesëmarrja e tyre është në diskrecion të palëve. Këtu listohen përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i NJMF, prokurori dhe/ose persona të tjerë të caktuar prej tij, siç mund të jenë oficerët e policisë gjyqësore. KDPM nuk shpjegon se çfarë roli kanë këta persona dhe çfarë qëllimi ka pjesëmarrja e tyre në procesin e ndërmjetësimit, megjithatë mund të themi se secili nga personat e listuar si "të tjerë" janë persona që ofrojnë dhe sigurojnë mbrojtjen e interesave të të miturit (si të miturit të akuzuar ashtu edhe kur edhe viktimat është i/e mitur)⁶⁵. KDPM thekson se është në diskrecionin e prokurorit dhe jo të palëve që të vendosë nëse mund të jetë e dobishme prania e tij në një proces ndërmjetësimi. Pavarësisht këtij parashikimi dhe faktit që kjo procedurë mund të vijë si propozim nga gjyqtari apo prokurori, këto subjekte nuk luajnë ndonjë rol aktiv pasi procedura e ndërmjetësimit zhvillohet jashtë procesit gjyqësor/hetimor. Vetëm në përfundim të procedurës së ndërmjetësimit, aktmarrëveshja e arritur nga palët i përcillet gjyqtarit/ prokurorit që e ka iniciuar.




⁶³ Ndërmjetësi është një person i tretë, i paanshëm, i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, dhe i specializuar në çështjet e drejtësisë penale për të miturit i cili lehtëson komunikimin midis palëve dhe synon lehtësimin e marrëveshjes për ndërmjetësim midis dy palëve të konfliktuara.

⁶⁴ Neni 64 pika 4 e KDPM

⁶⁵ Neni 64 i KDPM, Komentari Elektronik, <http://komentari elektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2017/37/47>

*Ndërmjetësimi familjar dhe në grup*⁶⁶ parashikohet gjithashtu në KDPM si një masë alternative për shmangien e ndjekjes penale, ku marrin pjesë bashkërisht me viktimën dhe të miturin në konflikt me ligjin, edhe të afërmit e tyre, persona nga rrethi i tyre shoqëror, përfaqësues nga institucione për mbrojtjen e të miturve, mbikëqyrjen e tyre dhe parandalimin e kriminalitetit për të miturit. Në këtë proces, i mituri dhe familja e tij pritet të arrijnë një marrëveshje me viktimën, e cila përfshin kompensimin e dëmit, kryerjen e detyrimeve që janë të pranueshme prej viktimës dhe që pritet të mbajnë të akuzuarin larg situatave konfliktuale të ngjashme në të ardhmen. Kjo mënyrë e zhvillimit të procesit të ndërmjetësimit paraqet veçantinë se përveç tre aktorëve kryesorë: të miturin e akuzuar për kryerjen e veprës penale, viktimën dhe ndërmjetësin në këtë procedurë bashkohen edhe familjarë, përfaqësues të shoqërisë ose organeve kompetente në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve. Mjafton që në njërën nga palët të ketë më shumë se dy persona, atëherë ndërmjetësimi do të konsiderohet në grup.



KUJDES!

Duhet mbajtur në konsideratë se ndërmjetësimi është një proces i zgjidhjes jashtëgjyqësisht të mosmarrëveshjes dhe si i tillë ai mund të propozohet dhe zbatohet deri sa gjykata ende nuk ka marrë një vendim dënimi ndaj të miturit në konflikt me ligjin. ***Ndërmjetësimi nuk mund të zbatohet për të miturin ndaj të cilit është marrë një vendim dënimi nga gjykata, e cila në këtë mënyrë ka zgjidhur edhe konfliktin midis palëve.*** Megjithatë, dhe nisur nga eksperiencat e suksesshme të vendeve të tjera, ***disa forma të tjera mund të përdoren për të përmirësuar marrëdhënien midis të miturit të dënuar dhe viktimës së veprës penale.***

Konferencat restauruese ose një takim grupi midis familjeve mund të riparojë marrëdhëniet si një hap i rëndësishëm për riintegrimin e të miturit ose si një mënyrë për të nxitur motivimin për tu larguar nga krimi dhe për të bashkëpunuar me ata që mund të mbështesin riintegrimin. Në ndryshim nga procesi i mirëfilltë i ndërmjetësimit i cili, lehtësohet nga një ndërmjetës i licencuar, këto konferenca restauruese apo takime grupi midis familjeve do të duhet të organizohen në kuadër të programeve të ndryshme dhe të lehtësohen nga punonjësit që, sipas rastit, kujdesen për zbatimin e masave që nxisin zhvillimin dhe riintegrimin e të miturit në shoqëri.


Zbatimi i masës së shmangies nga ndjekja penale realizohet dhe mbikëqyrjet nga Shërbimi i Provës⁶⁷, në bashkëpunim me shërbimin e ndërmjetësimit. Rrjedhimisht, përveç pjesëmarrjes së personave të tjerë, rolin kryesor në realizimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të masës e ka Shërbimi i Provës punonjësit e të cilit, në bashkëpunim me ndërmjetësin, ndihmojnë dhe mbështesin realizimin e procesit të ndërmjetësimit. Zhvillimi i procesit të ndërmjetësimit është në kompetencën dhe përgjegjësinë ekskluzive të ndërmjetësit, por punonjësi përgjegjës pranë Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës ku i mituri ka vendbanimin ose vendqëndrimin, për hir të përgjegjësisë që ka në realizimin dhe mbikëqyrjen e masës, do të ndërmarrë disa veprime gjatë zbatimit të masës, sipas hapave më poshtë⁶⁸.

Gjatë procedurës së mbikëqyrjes së masave të shmangies Shërbimi i Provës do të udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të të miturit dhe i ofron të miturit ndihmë sociale, edukative, arsimore, psikologjike, mjekësore dhe fizike në përshtatje me nevojat individuale dhe në përputhje me grup-moshën, gjininë dhe personalitetin e tij, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e tij në jetën shoqërore.

⁶⁷ Neni 70 pika 4 e KDPM

⁶⁸ Neni 25 i ligjit nr. 78/2020

Skema 2: Hapat që ndiqen për realizimin e procesit të ndërmjetësimit të caktuar si masë shmangie nga gjyqtari/prokurori



Ndërmjetësi:

- ✓ zgjidhet nga i mituri dhe pala e dëmtuar,
- ✓ nga lista e ndërmjetësve të specializuar në drejtësinë për të mitur.

Zhvillon procesin e ndërmjetësimit të caktuar si masë shmangie nga ndjekja penale.

Bashkëpunon me Shërbimin e Provës për të lehtësuar organizimin e procesit të ndërmjetësimit dhe procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të masës së shmangies.

b. Këshillimi për të miturin dhe familjen

Këshillimi për të miturin dhe familjen konsiston në informimin e të miturit dhe/ose familjes së tij, se ai ka kryer një vepër të dëmshme, të rrezikshme, e cila përbën vepër penale dhe me pasoja negative për viktimën dhe komunitetin. Masa e këshillimit për të miturin dhe/ose familjen e tij jepet kur kjo masë konsiderohet e mjaftueshme dhe në interes të të miturit dhe që do të ndikojë pozitivisht në sjelljen e tij.

KDPM parashikon se organi kompetent, sipas rastit, ngarkon NJMF ose shërbimet sociale dhe/ose psikologjike që të hartojnë një plan lidhur me mënyrën e realizimit të këshillimit dhe matjen e efekteve të tij hap pas hapi⁶⁹. Në disa bashki tashmë, janë zhvilluar programe të këshillimit për të miturin dhe familjen duke u dhënë mundësinë këtyre të fundit të përfitojnë nga këto programe⁷⁰. Megjithatë, këto programe duhet të zhvillohen në më shumë bashki, në varësi të nevojës dhe në mënyrë të planifikuar.

c. Paralajmërimi me gojë dhe me shkrim

Paralajmërimi me gojë përfshin gjithë shpjegimet që i jepen të miturit nga gjyqtari/prokurori, mbi dëmin e shkaktuar prej veprimeve të tij dhe pasojave që rrjedhin nëse vepra penale do të përsëritet. Veprimet e gjyqtarit/prokurorit lidhur me paralajmërimin me gojë pasqyrohen në një regjistër të veçantë⁷¹.

⁶⁹ Neni 65 pika 3 e KDPM

⁷⁰ Strategjia e Drejtësisë për të Mitur, 2022-2026, fq.16, https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Vendim-i-KM-892-DATE-27_12_2022.pdf


⁷¹ Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 4950, datë 02/05/2018 “Për përcaktimin e formës së regjistrimit të posaçëm të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale “paralajmërim me gojë”, http://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/Urdher_percaktimi-i-formes-se-regjistrimit-te-posacem-te-mases-alternative-te-shmangies-nga-ndjekja-penale_paralajmerim-me-goje-KDPM.pdf

Paralajmërimi me shkrim përfshin pasqyrimin në një procesverbal⁷² të të gjitha shpjegimeve të sipërpërmendura, që i jepen të miturit nga gjyqtari/prokurori. Një kopje e këtij procesverbal i jepet të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor.

a. Masat detyruese ndaj të miturit

Masat detyruese ndaj të miturit mund të jenë të natyrës “ndaluese” pra, që të miturit t’i ndalohen veprime të caktuara me qëllim shkëputjen e tij nga ndikimet negative apo që të sigurohet mbështetja dhe mbikëqyrja e nevojshme me qëllim riintegrimin e tij në shoqëri. Në këtë mënyrë të miturit mund t’i ndalohet të kontaktojë/takojë një person të caktuar, të shkojë/vizitojë një vend të caktuar, të ndryshojë vendin e banimit, të largohet nga shtëpia gjatë një periudhe/orari të caktuar, të largohet pa leje nga një vend ose nga një rajon administrativ i përcaktuar apo të kryejë ndonjë veprim tjetër që pengon rishoqërimin dhe rehabilitimin e tij⁷³.

Por KDPM parashikon edhe masa detyruese që synojnë përfshirjen e të miturit në proceset arsimore, punësim, programe edukative korrigjuese dhe/ose mjekësore me qëllim që të përforcojnë rishoqërimin e tij dhe parandalimin e rikryerjes së veprës penale⁷⁴.



⁷² Urdhër i Ministrisë së Drejtësisë nr. 4951, datë 02/05/2018 “Për miratimin e formatit dhe të dhënave për masën alternative të shmangies nga ndjekja penale “paralajmërim me shkrim”, http://drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/Urdher_miratimin-e-formatit-dhe-te-dhenave-per-masen-alternative-te-shmangies_paralajmerim-me-shkrim_KDPM.pdf

⁷³ Neni 68 pika 1 i KDPM

⁷⁴ Neni 68 pika 2 i KDPM

Është gjykata/prokurori, që sipas rastit, do të caktojë Shërbimin e Provës ose NJMF që të mbikëqyrë realizimin e këtyre masave⁷⁵. Pra, gjykata/prokurori në vendimin për marrjen e masës së shmangies caktojë institucionin mbikëqyrës për përmbushjen e masës (NJMF ose Shërbimi i Provës) por edhe institucionin, që për hir të veprimtarisë që mbulon, do të duhet të bashkëpunojë për realizimin e masës (autoritetit përgjegjës në fushën e arsimit dhe/ose të formimit profesional, të punësimit, shëndetësisë). Secili nga aktorët e përfshirë ka role të ndara dhe të qarta lidhur me zbatimin e masës por që përmbushja me sukses e saj kërkon bashkëpunimin e ngushtë midis tyre. Caktimi nga gjykata/prokurori i institucionit mbikëqyrës është i lidhur ngushtë me natyrën e masës që caktohet. Masat detyruese të natyrës ndaluese janë më të përshtatshme për tu mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës në bashkëpunim me NJMF ndërkohë që masat që kërkojnë përfshirjen në programe të caktuara mund të mbikëqyren nga NJMF në bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe institucionet ku do të zbatohet masa. Gjithsesi, institucioni mbikëqyrës do të vendoset rast pas rasti por në thelb të suksesit për përmbushjen e masës është bashkëpunimi ndërinstitucional.

Në analizën ligjore të hartuar⁷⁶ është identifikuar nevoja që, në të njëjtën mënyrë se si është vepruar për të siguruar zbatimin e nenit 102 të KDPM, të veprohet edhe për nenin 68 të KMD me qëllim që të sigurohet zbatimi efektiv i masave detyruese të shmangies. Kështu, është e nevojshme që me VKM të përcaktohen në mënyrë të qartë dhe të detajuar autoritetet në nivel qendror dhe vendor që do të duhet të bashkëpunojë për realizimin e masës, mënyra e bashkëpunimit me Shërbimin e Provës dhe NJMF, procedurat që ndiqen, etj.

⁷⁵ Neni 69 pika 4 e KDPM

⁷⁶ Analiza ligjore lidhur me procesin e riintegrit të të miturve në konflikt me ligjin dhe koordinimin ndërinstitucional, fq.38;

Gjykata/Prokurori

Ngarkon Shërbimin e Provës ose NJMF për mbikëqyrjen e zbatimit të masave detyruese të shmangies në bashkëpunim me:


Autoritetet kompetente qendrore:

- ❖ Ministria e Drejtësisë;
- ❖ Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit;
- ❖ Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, arsimit dhe formimit profesional (AFP);
- ❖ Ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetit dhe mbrojtjes sociale;
- ❖ Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

Autoritetet kompetente vendore:

- ✓ drejtuesi i njësisë arsimore vendore përgjegjës për arsimin profesional/ mësuesi i klasës apo mësuesi kujdestar;
- ✓ ofrues të AFP-së (shkollat publike profesionale)/ drejtuesit e programeve mësimore të arsimit dhe të formimit profesional/ mësuesit;
- ✓ drejtuesi i zyrës rajonale ose vendore të punësimit;
- ✓ shërbimet e shëndetit mendor për fëmijët dhe të rinjtë në nivel vendor; drejtoritë/institucionet e kujdesit të shëndetit (specialistët e shëndetit, mjekët e spitaleve, mjeku i familjes);
- ✓ strukturat e mbrojtjes së fëmijës;
- ✓ drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror;
- ✓ Urdhri i Psikologut;
- ✓ Urdhri i Punonjësve Socialë;
- ✓ strukturat vendore të Policisë së Shtetit;
- ✓ ofruesit publikë e privatë të shërbimeve për fëmijët, etj.

Skema 3: Hapat që ndiqen nga Shërbimi i Provës ose NJMF për zbatimin e masave detyruese të shmangies



b. Vendosja nën kujdes e të miturit⁷⁷

Nëse kujdesi i prindit ose kujdestarit të të miturit në konflikt me ligjin, në rritjen, sjelljen dhe zhvillimin e personalitetit të tij nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur qëllimin e masave detyruese dhe, kur është i nevojshëm kujdesi dhe mbikëqyrja e vazhdueshme nga ana e një personi ose shërbimit të specializuar, i mituri mund të vendoset nën kujdes në një program edukativ dhe/ose korrigjues.

KDPM parashikon⁷⁸ se programi edukativ dhe/ose korrigjues, realizohet sipas rastit, nga institucionet përgjegjëse që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, të cilët caktojnë persona të specializuar për zbatimin e kujdesit të vazhdueshëm. Këto të fundit, në bashkëpunim me të miturin, prindërit e tij, kujdestarin, institucionet e mirëqenies sociale dhe të arsimit, mjekë dhe profesionistë të tjerë, ushtrojnë ndikim të vazhdueshëm mbi personalitetin dhe sjelljen e të miturit, kujdesen për trajtimin e tij dhe mbikëqyrin përmbushjen e detyrimeve të tij, sipas një plani individual. Vendimi për vendosjen nën kujdes jepet, sipas rastit, nga prokurori ose gjykata për një periudhë nga gjashtë muaj deri në dy vjet.

Kujdesi dhe mbikëqyrja e vazhdueshme mund të realizohen pa qenë e nevojshme ndarja e plotë dhe e përhershme e të miturit nga mjedisi i tij i mëparshëm. Në vendimin për vendosjen nën kujdes, organi procedues mban parasysht që ekzekutimi i saj të mos e pengojë shkollimin e rregullt dhe punën e të miturit, si dhe përfshirjen e tij në aktivitete të dobishme që i shërbejnë riintegritimit. Aktivitetet përshtaten me moshën, zhvillimin, prirjet dhe interesat e të miturit, me qëllim zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë. Prindërit e të miturit të vendosur nën kujdes, mund të përfshihen në procesin e zbatimit të kësaj mase, nëse kjo nuk është në kundërshtim me interesat e të miturit.

Me dhënien e masës, gjykata/prokurori i jep prindërve ose kujdestarit udhëzime të veçanta dhe i vendos ata nën detyrimin për të bashkëpunuar me personin e specializuar në lidhje me të gjitha çështjet që mund të lindin. Gjukata/prokurori, nëse çmojnë se do të ishte e nevojshme për një zbatim më efektiv të masës së dhënë, mund të urdhërojnë gjithashtu që i mituri të përmbushë një ose më shumë masa detyruese.

Si në rastet e trajtuara më sipër, kjo përgjegjësi, për hir edhe të ndërhyrjeve që kërkohen, nuk mund të realizohet pa mbështetjen dhe bashkëpunimin ndërinstitucional. Personi i caktuar për kujdesin e vazhdueshëm ndaj të miturit në këto qendra në bashkëpunim me të miturin, prindërit e tij, kujdestarin, institucionet e mirëqenies sociale dhe të arsimit, mjekë dhe profesionistë të tjerë hartojnë një plan individual të trajtimit të të miturit. Ky plan individual, hartohet në përputhje me vendimin e gjyqarit/prokurorit që ndër të tjera duhet të parashikojë edhe përgjegjësitë dhe detyrat që duhet të përmbushen nga ana e qendrës disiplinore/edukuese, afatet për paraqitjen periodike të raporteve të vijueshmërisë së trajtimit të të miturit dhe progresit të tij, si dhe mundësinë që në varësi të zhvillimeve pozitive, koha e përkujdesjes të reduktohet nga afati fillestar i vendosur. Gjatë

⁷⁷ Neni 69 pika 2 e KDPM

⁷⁸ Neni 69 pika 2 i KDPM

hartimit të planit individual, mbahet në konsideratë edhe raporti i vlerësimit individual të të miturit, i cili pasurohet me elementë të tjerë që lidhen me trajtimin, masat që do të ndërmerren, programi ku do të përfshihet i mituri, realizimi i mbikëqyrjes (e plotë apo e pjesshme), masa që duhen marrë në rastin kur i mituri është me aftësi të kufizuara, përfshirja e prindërve/kujdestarit, realizimi i masave detyruese (në rast se janë vendosur), bashkëpunimin me institucionet e mësipërme që ushtrojnë një ndikim të vazhdueshëm mbi personalitetin dhe sjelljen e të miturit, kujdesen për trajtimin e tij dhe mbikëqyrin përmbushjen e detyrimeve të tij.

Në përputhje me vendimin e gjykatës/prokurorit, personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të masës do t'i dërgojë prokurorit raportet e vijueshmërisë së trajtimit të të miturit dhe progresit të tij të cilët, duhet t'i dërgohen për dijeni edhe përfaqësuesit ligjor të të miturit, i cili ka të drejtë të kërkojë reduktimin e kohës së përkujdesjes në këto qendra sa herë vlerësohet ndryshim pozitiv i të miturit. Në përfundim të afatit të vendosjes nën kujdes të të miturit, personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të masës njofton me shkrim prokurorin lidhur me realizimin e masës dhe detyrimeve të caktuara.

Sipas KDPM, shërbimi i specializuar realizohet nga qendra disiplinore/edukuese të krijuara sipas legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve⁷⁹. Një ligj tjetër që kërkon vëmendje në këtë analizë është edhe Ligji nr. 121, datë 21.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore⁸⁰ në zbatim të tij të cilët përcaktojnë shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial dhe përfituesit. Sipas Ligjit nr. 121, datë 21.11.2016, të miturit në konflikt me ligjin janë përfitues edhe të *shërbimeve të specializuara që janë shërbimet e ofruara nga profesionistë të profilizuar në specialitete të ndryshme. Këto shërbime ofrohen në nivel qarku/rajonat dhe bashkie edhe për fëmijët në konflikt me ligjin. Vendosja e të miturit nën kujdesin e një shërbimi të specializuar sipas nenit 69 të KDPM-së duket se i referohet pikërisht shërbimeve të specializuara të krijuara posaçërisht për të miturit në konflikt me ligjin sipas legjislacionit për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe jo sipas legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Gjithashtu, rezulton se pavarësisht parashikimeve të kuadrit ligjor të sipërpërmendur, nuk ka të dhëna lidhur me ngritjen dhe funksionimin e qendrave disiplinore/edukuese në nivel vendor, çfarë sjellë si pasojë moszbatimin e plotë të dispozitave të KDPM dhe masave të shmangies të parashikuara.*


Kodi Penal parashikon në nenin 46 të tij “masat mjekësore dhe edukuese”. Sipas këtij neni, masat edukuese mund të jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale. *Masa edukuese është “Vendosja e të miturit në një institucion edukimi”. Edhe në këtë rast situata paraqitet e njëjtë si më sipër.*

Ministria e Drejtësisë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 33 bashki për realizimin dhe mbikëqyrjen e masave të shmangies. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve, bashkitë angazhohen

⁷⁹ Neni 69 pika 9 e KDPM

⁸⁰ VKM Nr. 518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, https://eëë.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2014/03/VKM-518_dt_04.09.2018.pdf

ndër të tjera të ofrojë shërbime sociale të përkujdesit për të miturit dhe familjet e tyre si dhe të shqyrtojë me përparësi kërkesat për shërbime sociale, të cilat rezultojnë të munguara duke i përfshirë në planifikimin e nevojave për shërbime dhe ngritjen e shërbimeve të reja. Pra, ngritja e shërbimeve të specializuara për të miturit nuk është vetëm detyrim ligjor por edhe një prioritet në kuadër të zbatimit efektiv të masave të shmangies sipas përcaktimeve në Marrëveshjet e Bashkëpunimit.




3.2.3. Gjykimi i çështjes/vendimi penal ndaj të miturit

Në përfundim të hetimeve, kur prokurori konsideron se ka mjaftueshëm prova për provuar fajësinë e të miturit e dërgon çështjen në gjykatë. Gjykimi i çështjes me të mitur do të bëhet nga **gjyqtarë të specializuar** në drejtësinë penale për të mitur, të caktuar pranë **seksioneve të posaçme për të miturit** në Gjykata.


Gjykimi i çështjes përfundon me dhënien e vendimit të fajësisë apo pafajësisë nga gjykata, e cila mban në konsideratë se dënimi me burgim do të përdoret vetëm si një masë e fundit, për një kohë sa më të shkurtër dhe duke u rishikuar periodikisht.

Në çdo rast, qëllimi i dënimit të të miturit është rishoqërimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale ose i kryerjes së një vepre tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje.

Gjatë gjithë procesit të marrjes së vendimit, gjykata, mban në konsideratë se dënimi me burgim i të miturit është mjeti i fundit i mundshëm, i cili konsiderohet vetëm nëse masat e shmangies janë të papërshtatshme.



Ndaj të miturit mund të jepet vetëm një dënim kryesor. Dënimi kryesor mund të jepet së bashku më jo më shumë se një dënim plotësues.



✚ *Dënimi jo me burgim i të miturit*

Nëse i mituri shpallet fajtor për veprën penale, atëherë ai mund të marrë një dënim jo me burgim ose me burgim. Në dënimet jo me burgim përfshihen:

✚ *kufizimi i lirisë*⁸¹ është vendosja e të miturit në një institucion/qendër nën mbikëqyrje pa u izoluar nga shoqëria dhe komuniteti, me qëllim edukimin dhe rehabilitimin përmes programeve të posaçme. Mjediset, në të cilat realizohet kufizimi i lirisë duhet të kenë shpërndarje gjeografike në të gjithë territorin e vendit, me qëllim që të miturve t'u garantohet kontakti me familjarët e tyre dhe duhet të jenë të integruara me mjedisin shoqëror, ekonomik dhe kulturor të komunitetit. Me VKM nr. 233, datë 17.4.2019⁸² janë përcaktuar rregullime të veçanta, lidhur me funksionimin e mjediseve dhe përcaktimin e nivelit të sigurisë të tyre, standardet e programeve të edukimit dhe të rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve. *Megjithatë, dhe pavarësisht se KDPM parashikon një shpërndarje gjeografike në të gjithë territorin e vendit, deri më sot është parashikuar krijimi i Institucionit të Kufizimit të Lirisë si një institucion gjysëm i hapur ku të miturit në konflikt me ligjin, të trajtohen pa u izoluar përmes programeve të përshatshme për edukimin, rehabilitimin dhe riintegrimin në komunitet dhe në shoqëri dhe shmangien e përfshirjes së tyre në rrugën e kriminalitetit dhe uljen e recidivizimit. Ky institucion nuk është ende funksional*⁸³. *Një risi tjetër në këtë drejtim është edhe rikonceptimi i këtij institucioni si institucioni jo vetëm i kufizimit të lirisë por edhe si institucion për edukimin dhe rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin*⁸⁴.

✚ *gjoba* e cila mund të zbatohet për një të mitur nëse ka të ardhura monetare nga një burim

⁸¹ Neni 98 i KDPM

⁸² Me VKM nr. 233, datë 17.4.2019⁸² "Për përcaktimin e rregullimeve të veçanta lidhur me funksionimin e mjediseve, të nivelit të sigurisë së tyre dhe standardet e programeve të edukimit e të rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve".

⁸³ Janë kryer nga ana e MD procedurat që lidhen me pjesën arkitekturore të projektit; përcaktimin e vendit ku do të ngrihet ky institucion; draft dokumentacioni i brendshëm për vënien në funksion. Projekti është paraqitur tek partnerët ndërkombëtarë dhe pranë Ministrisë së Financave për mundësi financimi; është mbyllur procedura e tenderimit;

⁸⁴ Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2022–2026, fq.41, https://ëëë.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2023/02/Vendim-i-KM-892-DATE-27_12_2022.pdf

i ligjshëm. Masa e saj është sa gjysma e gjobës që do t'i jepej një të rrituri në të njëjtat kushte, sipas parashikimeve të Kodit Penal;

- ✚ **ndalimi për kryerjen e një veprimtarie** për një periudhë kohore nga një deri në tre vjet, nëse kjo çmohet si e papërshtatshme nga gjykata për rehabilitimin e të miturit dhe parandalimin e kryerjes prej tij të veprave penale të tjera;
- ✚ **kryerja e një pune me interes publik** që zbatohet në mënyrë të tillë që të mos pengojë procesin e edukimit dhe mund të shoqërohet me detyrimin për ndjekjen e një kursi profesional dhe ku përvoja i shërben të bëhet një njeri i denjë. Në përgjithësi, dënimi me punë në interes publik është një dënim më i mirë dhe kuptimplotë për të miturin nëse ekzistojnë institucionet që mund të organizojnë punën në interes publik.
- ✚ **përmbushja e detyrimeve të caktuara të tilla si:**
 - të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose, sipas rastit, një program arsimimi;
 - të ndjekë një program të formimit profesional;
 - të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës e siguruar nga programet sociale të punësimit;
 - të riparojë dëmin civil të shkaktuar;
 - të ndjekë një program rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës;
 - të mos frekuentojë vende të caktuara;
 - të mos shoqërohet me persona të caktuar, të cilët mund të ndikojnë negativisht në sjelljen dhe edukimin e tij.
- **qëndrimi në shtëpi** që zbatohet në mënyrë të tillë që të mos cenojë procesin arsimor dhe/ose të punësimit të të miturit;

Siç vihet re, disa nga dënimet jo me burgim të sipërpërmendura kanë në vetvete qëllim riintegruar dhe rehabilitues për të miturin dhe ato merren pasi të miturit i është bërë një vlerësim individual. Përmbushja e detyrimeve të caktuara nga gjykata ka si qëllim rishoqërimin, riintegrimin, rehabilitimin dhe parandalimin e rikryerjes së veprës penale ose kryerjes së një veprë tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje.

✚ **Vendimi me burgim**

Kur ndaj të miturit është marrë nga gjykata vendimi me burgim, atëherë i mituri vendoset në seksione/institucione të posaçme të vuajtjes së dënimit për të mitur (Institutin e të Miturve në Kavajë).

Trajtimi i të miturit në I EVP mbështetet në interesin më të lartë të tij, në riintegrimin shoqëror, edukimin dhe parandalimin e përsëritjes së veprave penale nga i mituri, në përputhje me kushtet dhe rregullat e parashikuara në KDPM. Veprimtaria e I EVP duhet të synojë të ofrojë ndihmë sociale, edukative, arsimore, psikologjike, mjekësore në përshtatje me nevojat individuale dhe në përputhje me grup-moshën, gjininë dhe personalitetin e të miturit, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e tij në jetën shoqërore.


3.2.4. Ekzekutimi i vendimit penal

Vendimi penal vihet në ekzekutim kur merr formë të prerë me anë të urdhrorit për ekzekutim që lëshon prokurori.

✚ Ekzekutimi i vendimit të dënimit jo me burgim

Ekzekutimi i vendimit të dënimit jo me burgim mbikëqyret dhe zbatohet nga Shërbimi i Provës¹, i cili gjatë këtij procesi udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të të miturit dhe i ofron të miturit ndihmë sociale, edukative, arsimore, psikologjike, mjekësore dhe fizike në përshtatje me nevojat individuale dhe në përputhje me grupmoshën, gjininë dhe personalitetin e tij, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e tij në jetën shoqërore.

Skema 4: Hapat që ndiqen nga Shërbimi i Provës për zbatimin dhe mbikëqyrjen e vendimit të gjykatës për dënimin jo me burgim të të miturit



Shembull: Kur gjykata ka vendosur ndaj të miturit kryerjen e një pune në interes publik, specialisti i Shërbimit të Provës përgjegjës për mbikëqyrjen, përcakton institucionin apo shoqërinë publike apo private ku do të kryhet puna, në rastet kur nuk është përcaktuar nga gjykata si dhe llojin e punës dhe ditët e javës. Specialisti i Shërbimit të Provës, në përcaktimin e institucionit ku do të kryhet puna, merr në konsideratë vendbanimin e të miturit si dhe rrethanat individuale të tilla si: moshë, niveli i zhvillimit, kushtet e jetesës, mënyra e rritjes dhe e zhvillimit, edukimi dhe arsimimi, gjendja shëndetësore, gjendja familjare dhe rrethanat e tjera. Kur brenda territorit nuk ka një institucion të përshtatshëm, specialisti cakton një institucion tjetër të së njëjtës natyrë, i cili ndodhet në rrethin më të afërt me vendbanimin e të miturit.

🚩 Ekzekutimi i vendimit të dënimit jo me burgim/ përmbushja e detyrimeve të caktuara

Kur gjykata cakton ndaj të miturit në konflikt me ligjin, një ose disa detyrime për t'u përmbushur, organi kompetent që ndjek përmbushjen e detyrimit të dhënë ndaj të miturit caktohet në vendimin e gjykatës, duke mbajtur në konsideratë llojin e detyrimit. Një listë treguese e këtyre organeve, në nivel qendror dhe vendor, e shoqëruar me përgjegjësitë dhe procedurat e tyre, jepet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 207/2019⁸⁵. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore dhe drejtuesi i NJMF përgatit e përditëson listat e autoriteteve kompetente dhe të personave përgjegjës dhe ia dërgon ato strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe Gjykatës.

⁸⁵ VKM nr. 207, date 10.4.2019 “Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe të procedurës që do të ndiqet për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin”, <http://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2019/05/VKMNR22.pdf>

Gjykata vendos dënimin jo me burgim të të miturit për përmbushjen e një ose disa detyrimeve dhe cakton organin kompetent që ndjek përmbushjen e detyrimit

Detyrimet e caktuara nga gjykata:

- ❖ Të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose, sipas rastit, një program arsimimi;
- ❖ Të ndjekë një program të formimit profesional, sipas ligjit për arsimin profesional;
- ❖ Të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës e siguruar nga programet sociale të punësimit;
- ❖ Të riparojë dëmin civil të shkaktuar;
- ❖ Të ndjekë një program rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës;
- ❖ të mos frekuentojë vende të caktuara;
- ❖ të mos shoqërohet me persona të caktuar, të cilët mund të ndikojnë negativisht në sjelljen dhe edukimin e tij.

Autoritetet kompetente qendrore:

- ❖ Ministria e Drejtësisë;
- ❖ Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit;
- ❖ Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, arsimit dhe formimit profesional (AFP);
- ❖ Ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetit dhe mbrojtjes sociale;
- ❖ Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

Autoritetet kompetente vendore:

- ✓ drejtuesi i njësisë arsimore vendore përgjegjës për arsimin profesional/ mësuesi i klasës apo mësuesi kujdestar;
- ✓ ofrues të AFP-së (shkollat publike profesionale)/ drejtuesit e programeve mësimore të arsimit dhe të formimit profesional/ mësuesit;
- ✓ drejtuesi i zyrës rajonale ose vendore të punësimit;
- ✓ shërbimet e shëndetit mendor për fëmijët dhe të rinjtë në nivel vendor; drejtoritë/institucionet e kujdesit të shëndetit (specialistët e shëndetit, mjekët e spitaleve, mjeku i familjes);
- ✓ strukturat e mbrojtjes së fëmijës;
- ✓ drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror;
- ✓ Urdhri i Psikologut;
- ✓ Urdhri i Punonjësve Socialë;
- ✓ strukturat vendore të Policisë së Shtetit;
- ✓ ofruesit publikë e privatë të shërbimeve për fëmijët, etj.

Pasi gjykata vendos dënimin jo me burgim të të miturit për përmbushjen e një ose disa detyrimeve duke caktuar edhe organin kompetent që ndjek përmbushjen e detyrimit, hapat që ndiqen janë:

Hapi 1: Hartimi i Planit të Trajtimit Individual të të miturit nga NJMF e bashkisë ku i mituri ka vendbanimin apo vendqëndrimin. Plani i hartuar i përcillet drejtuesit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki dhe autoritetit kompetent të caktuara nga gjykata për përmbushjen e detyrimit.

Plani individual përmban:

- ❖ *njësinë e vetëqeverisjes vendore pranë së cilës i mituri do të përmbushë detyrimin;*
- ❖ *aktivitetet konkrete të të miturit për përmbushjen e detyrimit;*
- ❖ *të drejtat e të miturit;*
- ❖ *masa të tjera të veçanta (si, këshillim psikologjik, kurse për menaxhimin e zemërimit, trajtim të shëndetit mendor, shërbimet sociale/ të punësimit që i ofrohet atij dhe familjes, shërbimet shëndetësore, bashkëpunimin me shoqërinë civile etj);*
- ❖ *masa për mbështetjen e të miturit në çdo ndërhyrje që do të përmirësonte situatën familjare dhe rolin e familjes;*
- ❖ *të dhënat dhe kontaktet e personit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të tij si dhe të drejtat e detyrat e tij;*
- ❖ *kohëzgjatjen e planit individual, komunikimin dhe njoftimet gjatë zbatimit të planit individual, rregulla lidhur me ndryshimin e planit, pasojat e moszbatimit të planit, bashkëpunimi institucional dhe ndarja e përgjegjësi; e drejta e ankimit etj;*

Hapi 2: Miratimi i Planit të Trajtimit Individual të të miturit nga drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki dhe autoriteti/et përgjegjëse, të caktuara në vendimin e gjykatës.

Hapi 3: Lehtësimi i zbatimit të Planit të Trajtimit Individual të të miturit nga drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki dhe autoriteti kompetent i caktuar nga gjykata për përmbushjen e detyrimit, jo me vonë se 10 ditë nga marrja e vendimit.

Hapi 4: Bashkëpunimi i autoriteteve kompetente për zbatimin e Planit të Trajtimit Individual të të miturit (drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki dhe autoriteti kompetent i caktuar nga gjykata) **me grupin teknik ndërsektorial në bashki dhe organizatat jo-fitimprurëse**, që ofrojnë shërbime në fushën e të drejtave të të miturve.

Hapi 5: Monitorimi i zbatimit të Planit të Trajtimit Individual të të miturit dhe i respektimit të të drejtave të të miturit nga autoriteti përgjegjës i caktuar nga gjykata për përmbushjen e detyrimit dhe nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijës i caktuar nga drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki. dhe të respektimit të të drejtave të të miturit.


Hapi 6: Njoftimi i të miturit, prindin, përfaqësuesin ligjor nga autoriteti përgjegjës i caktuar nga gjykata për përmbushjen e detyrimit në rast të mos përmbushjes nga i mituri të detyrimit/eve të caktuara nga gjykata, me qëllim marrjen e masave konkrete dhe zgjidhjen e rastit. Në raste se i mituri, me gjithë masat e marra nuk përmbush detyrimin/et e caktuar nga

gjkata, autoriteti përgjegjës *vë në dijeni drejtuesin e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë dhe punonjës in e NJMF*, të cilët marrin masa të menjëhershme. Kur moszbatimi i detyrimit/eve të caktuar nga gjykata vazhdon nga i mituri, punonjësi i zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë dhe punonjësi i NJMF marrin masa për të *njoftuar në mënyrë të menjëhershme gjykatën*.


Ekzekutimi i vendimit të dënimit me burgim

Kur ndaj të miturit është marrë nga gjykata vendimi me burgim, atëherë i mituri vendoset në një institucion të posaçëm të vuajtjes së dënimit për të mitur që është Instituti i të Miturve në Kavajë (në vijim IEVP për të mitur).

Veprimtaria rehabilituese në vendin e vuajtjes së dënimit për të miturin ka për qëllim kryesor të përgatisë të miturin për lirin e tij, me qëllim rehabilitimin e tij dhe kthimin në jetën shoqërore.



Skema 5: Hapat që ndiqen nga IEVP gjatw vuajtjes sw dwnimit me burgim tw tw miturit pwr tw siguruar riintegrimin e tij nw shoqwrri



4. PROCESI I RIINTEGRIMIT TË TË MITURIT PAS VUAJTJES SË DËNIMIT ME BURGIM/LIRIMIT ME KUSHT

Për të miturin e dënuar me burgim riintegrimi është një fazë që nis në kohën kur i mituri është duke kryer dënimin penal e vazhdon edhe pas kryerjes së dënimit. Kjo mënyrë konceptimi e fazës së riintegritimit të të miturit nga ana e KDPM-së e zbut gjendjen e tij të dikurshme, kur ai, pasi përfundonte dënimin, ishte krejtësisht i shkëputur, i turbulluar, i papërgatitur dhe pa asnjë pikësnyim. Për të miturit që e kanë kryer dënimin në IEVP për të mitur, është i nevojshëm një monitorim më i shpeshtë dhe intensiv. Faza e riintegritimit kërkon më tepër mbështetje për këta fëmijë, pasi, për periudha pak a shumë të gjata, ata kanë qenë të shkëputur nga jeta e përditshme e moshatarëve të tyre, nga familja, edukimi dhe marrëdhëniet sociale.

Në përfundim të dënimit, IEVP për të mitur, duke mbajtur kontakte të vazhdueshme informuese me NJMF, Policinë e Shtetit, QPKMR dhe familjen e të miturit apo kujdestarin e tij, merr masat që të hartojë dhe miratojë një plan me një strategji konkrete të riintegritimit të të miturit. Ky plan është sinteze dhe përfundim konkret i aktiviteteve dhe dinamikës së ndjekur gjatë vuajtjes së dënimit të të miturit nëpërmjet programeve të veçanta për riintegrim, të cilat janë pjesë përbërëse e planit të përgatitjes për lirim.

Kështu, jo më pak se tre muaj para datës së mbarimit të dënimit (lirimit me kusht), IEVP⁸⁶:

- ✓ informon për datën e mbarimit të dënimit të miturin, përfaqësuesin e tij ligjor, Shërbimin e Provës, QPKMR dhe NJMF;
- ✓ i jep mbështetje psikologjike dhe arsimore të miturit për t'u përgatitur për lirim;
- ✓ i jep mundësi të miturit që të bëjë vizita të shkurtra në shtëpi;
- ✓ përgatit një dokument me të dhënat mbi situatën sociale të të miturit, me qëllim që të përforcojë rishoqërimin e mëvonshëm të të miturit;
- ✓ i jep informacion të miturit në mënyrë të kuptueshme për të, me qëllim që ai të ketë aksesin e duhur për mbështetje dhe ndihmë pas kryerjes së dënimit;
- ✓ bashkëpunon me organin shëndetësor të vendbanimit të të miturit në mënyrë që të zbatohet plani i riintegritimit për aspekte që mund të lidhen me anën shëndetësore të të miturit;
- ✓ llogarit dhe miraton paraprakisht fonde për ti mundësuar mbështetje financiare për shpenzime të domosdoshme të të miturit si nevoja të veçanta në momentin e lirimit (veshje, transport etj);

Në rastet kur i mituri ka paraqitur kërkesën për lirim me kusht, Shërbimi i Provës kryen vlerësimin e rrezikut familjar dhe shoqëror si dhe vlerëson nevojat e të miturit jashtë IEVP-së. Specialisti i Shërbimit të Provës përgjegjës për plotësimin e dokumentit të lirimit me kusht:

- ✓ interviston të miturin në institucionin ku është duke vuajtur dënimin;

⁸⁶ Neni 133 i KDPM

- ✓ kontakton anëtarë të familjes, si dhe çdo person tjetër që mund të ofrojë informacion të dobishëm për vlerësim;
- ✓ kontakton me specialistin e edukimit/psikologun e institucionit për të marrë informacion në lidhje me sjelljen e të miturit gjatë kryerjes së dënimit, bashkëpunimi dhe sjellja me të miturit e tjerë, përfshirja në aktivitete, pjesëmarrja në kurse profesionale, vazhdimin e programit arsimor, qëndrimi ndaj veprës penale;
- ✓ plotëson instrumentin e vlerësimit të rrezikshmërisë (YRNAS) me anë të së cilës, analizon faktet e të dhënave kriminale të veprimeve të kryera në të kaluarën, personalitetin e të miturit, kushtet familjare, natyrën e krimit të kryer prej tij dhe rrethana të tjera, të cilat mund të ndikojnë në dhënien e vendimit për lirin e parakohshëm;
- ✓ jep vlerësimin e tij në lidhje me lirin ose jo të të miturit;

Në rast të lirit të të miturit, IEVP për të mitur bashkëpunon me QPKMR, organet e qeverisjes vendore dhe NJMF ku i mituri banon apo ka planifikuar të banojë për përgatitjen e planit të rishoqërizimit dhe rehabilitimit të të miturit në një periudhë deri në tre muaj nga lirimi i tij nga IEVP-ja.

Në rast të lirit me kusht të të miturit, Shërbimi i Provës bashkëpunon me QPKMR, IEVP për të mitur, organet e qeverisjes vendore dhe NJMF ku i mituri banon apo ka planifikuar të banojë për përgatitjen e planit të rishoqërizimit dhe rehabilitimit të të miturit në një periudhë deri në tre muaj nga lirimi i tij nga IEVP-ja.

Plani miratohet nga QPKMR dhe NJMF të cilët janë edhe institucionet përgjegjëse për koordinimin e masave dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij plani për të paktën gjashtë muaj nga kryerja e dënimit ose e lirit me kusht.

Pas lirit, i mituri mbështetet nga institucionet e parashikuara në planin e rishoqërizimit dhe rehabilitimit për të bërë të mundur një riintegrim të suksesshëm të tij. Për të mbështetur procesin e riintegrit, organet e qeverisjes vendore në bashkëpunim me NJMF, bëjnë të mundur strehimin e përshtatshëm dhe të përkohshëm për të miturin që nuk ka strehim si dhe i sigurojnë atij veshje të përshtatshme, mbështetje psikologjike, shpenzimet e udhëtimit për në banesë, mundësimin e ndjekjes së kurseve të formimit profesional. Gjithashtu, QPKMR kujdeset për mbikëqyrjen e cilësisë së ofrimit të shërbimit ndaj të miturit.

Skema 6: Hapat që ndiqen dhe institucionet përgjegjëse për të siguruar riintegrimin e të miturit pas përfundimit të dënimit

